



**Bashkimi Evropian**

**Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të  
Njeriut**

**Kosovë**

**Raporti vjetor**

**01.01.2011 – 31.12.2011**

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

## Përmbajtja

Parathënie:.....	3
1. Hyrje .....	5
2. Rregullorja e punës .....	6
3. Paneli dhe Sekretariati .....	7
3.1. E përgjithshme .....	7
3.2. Anëtarët e Panelit .....	7
3.3. Anëtari zëvendësues.....	9
3.4. Ish anëtarët e Panelit .....	9
3.5. Sekretariati .....	12
4. Veprimtaritë e Panelit .....	13
4.1. Fushata informuese 2011 .....	13
4.2. Trajnimi hyrës për personelin e EULEX-it.....	14
4.3. Faqja e internetit .....	15
5. Ankesat në Panel.....	15
5.1. Numri i lëndëve.....	15
5.2. Shkeljet e të Drejtave të Njeriut nga EULEX-i në Kosovë .....	15
5.3. Veprimet e EULEX-it në Kosovë rreth lëndës Kazagic .....	16
5.4. Veprimet e EULEX-it në Kosovë rreth lëndës Rudi .....	17
5.5. Ankesat e zakonshme.....	17
5.6. Subjekti i ankesave .....	18
6. Jurisprudenca e Panelit .....	19
6.1. Çështjet e pranueshmërisë.....	19
6.1.2 Afatet kohore për paraqitjen e një ankese.....	19
6.1.3 Pranueshmëria racione personae .....	19
6.1.4 Procedurat gjyqësore pranë gjykatave të Kosovës.....	20
6.2 Çështjet thelbësore .....	20
6.2.1 E drejta për gjykim të drejtë (Neni 6 (1) i Konventës) .....	20
6.2.2 E drejta për mbrojtjen e pronës (Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës) ....	21
7. Çështjet Operative/Administrative/të Personelit.....	26
7.1 Fushata informuese .....	26
7.2 Papranueshmëria e ankesave.....	27
7.3 Çështjet e personelit .....	27
7.4 Buxheti .....	28
8. Përfundim.....	28
ANNEX 1 Tabela e personelit .....	29
ANNEX 2 Orari i takimeve që kanë të bëjnë me fushatën informuese .....	30
ANNEX 3 Statistikat.....	38
ANNEX 4 Vendimet e PShDNj.....	39
ANNEX 5 Rregullorja e punës .....	42

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

## **Parathënie:**

Ky është raporti i dytë vjetor i Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (më tutje: Paneli), i cili mbulon vitin e parë të tij të punës gjatë vitit 2011. Paneli i themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009 ka vazhduar me shqyrtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, si dhe zhvillimin e jurisprudencës së tij. Veçanërisht, Paneli është mekanizmi i vetëm i këtij lloji që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e misionit të Politikës së Përbashkët të Bashkimit Evropian për Siguri dhe Mbrojtje (PPSM). Mund të shihet si një projekt model që do të ndihmojë zhvillimin e formave të reja të mekanizmave llogaridhënës të të drejtave të njeriut në kontekste të tjera.

Gjatë kësaj periudhës raportuese Paneli ka zhvilluar gjashtë sesione dhe është parë se ka pasur një rritje të madhe të numrit të lëndëve, duke pranuar njëzet e tetë ankesa të reja. Gjatë periudhës raportuese Paneli është marrë me gjithsej tridhjetë raste dhe ka konstatuar se EULEX-i në Kosovë në dy raste ka shkelur të drejtat e njeriut.

Në mënyrë që të rris ndërgjegjësimin rreth mandatit dhe funksioneve të tij tek institucionet e Kosovës dhe publiku, Paneli ka shtuar fushatën informuese e cila ka përfshirë nisjen e fushatës në Serbi në janar të vitit 2011. Paneli ka mbajtur shumë takime me OJQ që merren me të drejtat e njeriut dhe ka vizituar institucionet e nivelit të tretë shkollor si dhe takime me ministra përkatës qeveritar dhe zyrtarë vendor të qeveritarisë/administratës në nivelin rajonal dhe komunal. Gjithashtu janë zhvilluar disa intervista me gazetarë të radiove, televizioneve dhe gazetave.

Ndër pikat kryesore të fushatës informuese të vitit 2011 ka qenë takimi i Panelit me koordinatorët dhe zyrtarët e Departamentit qeveritar dhe të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore në muajin prill, dhe fjalimi i Sekretariatit para disa qindra avokatëve në “Ditën e Avokatëve” në Odën e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë.

Megjithatë, fushata informuese gjatë këtij viti ishte përqendruar në institucionet komunale, ku ishin mbajtur takime me kryetarët e komunave, kryetarët e gjykatave komunale dhe gjykatave për kundërvajtje si dhe me komandantët e stacioneve policore komunale apo zëvendësit, përfaqësuesit e tyre.

Pas dorëheqjes së znj. Gabrielle Gaube dhe z. Francesco Florit në përbërjen e Panelit ka pasur disa ndryshime. Pas këtyre dorëheqjeve janë emëruar anëtarë të rinj të Panelit dhe anëtarë zëvendësues të Panelit të paraqitur si në vijim: znj. Esmë Erterzi, znj. Anna Bednarek dhe znj. Verginia Micheva-Ruseva. Sekretariati i Panelit gjithashtu ka punësuar zyrtaren e dytë ligjore, znj. Stephanie Selg.

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

Do të doja të përfitoja nga ky rast për të shprehur mirënjohjen time ndaj të gjithë anëtarëve të Panelit, ndaj ish anëtarëve dhe anëtarë të tanishëm, për kontributin e tyre të madh profesional në punën e Panelit gjatë kësaj periudhe raportuese. Poashtu, do të doja të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për Shefin e Misionit të EULEX-it dhe Shefin e zyrës për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore të EULEX-it për mbështetjen, bashkëpunimin, ndihmën e tyre të shkëlqyeshme gjatë këtij viti.

Paneli është i mendimit se një mekanizëm i jashtëm llogaridhënës është pjesa thelbësore për misionin më të madh civil deri më tani nën PPSM. Ekzistenca e një procedure të jashtme dhe të pavarur për shqyrtimin e të drejtave të njeriut dëshmon përkushtimin e EULEX-it për përfilljen e të drejtave të njeriut. Kjo, nga ana tjetër, mund të frymëzoj autoritetet e Kosovës që në një kontekst sfidues shumë etnik të nxis një kulturë për llogaridhënie, ku përfillja e të drejtave të njeriut duhet të konsiderohet si gur themel për zhvillimin e institucioneve demokratike. Paneli gjithashtu mund të luaj një kontribut të rëndësishëm në suksesin e misionit EULEX në Kosovë.

31 janar 2012

Antonio Balsamo  
Kryesues  
Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

## 1. Hyrje

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, (më tutje: Paneli) i themeluar nga Bashkimi Evropian më 29 tetor 2009 ka vazhduar me shqyrtimin e shkeljeve të dyshuara të të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv gjatë vitit të parë të tij të punës në vitin 2011. Paneli është mekanizëm i parë dhe i vetëm që merret me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut nga një mision i përbashkët i Bashkimit Evropian për Siguri dhe Polici.

Gjatë kësaj gjithë periudhës raportuese, Paneli ka zhvilluar gjashtë (6) sesione dhe ka pranuar njëzet e tetë (28) ankesa të reja. Paneli ka shqyrtuar dhjetë (10) raste të papërfunduara që janë bartur nga viti 2010. Paneli ka gjetur se tetë (8) prej këtyre ankesave janë të papranueshme dhe se EULEX-i në dy (2) raste kishte shkelur të drejtat e njeriut të parashruesve të ankesave.

Gjithashtu Paneli ka shqyrtuar njëzet (20) prej njëzet e tetë (28) ankesave që i ka pranuar në vitin 2011. Nëntëmbëdhjetë (19) prej këtyre ankesave janë gjetur të papranueshme dhe një (1) ankesë ishte hequr nga lista e rasteve për shkak të humbjes së interesimit nga ana e parashtruesit të ankesës.

Paneli ka vazhduar me fushatën informuese, e cila përfshinte nisjen e fushatës në Serbi në muajin janar dhe takime me OJQ për të drejta të njeriut, vizita në institucionet shkollore të nivelit të tretë si dhe takime me ministra përkatës të qeverisë dhe zyrtarë të qeverisjes/administratës lokale në nivelin regional dhe komunal.

E një rëndësie të veçantë ishte takimi i Panelit me diku shtatëdhjetë e pesë (75) koordinatorë dhe zyrtarë për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore nga departamentet qeveritare dhe komunale në ndërtesën e qeverisë në Prishtinë në muajin prill, si dhe kur Sekretariati iu është drejtuar disa qindra avokatëve në “Ditën e Avokatëve” të Odës së Avokatëve të Kosovës në hotelin Grand në Prishtinë në muajin qershor.

Fushata informuese më së shumti ishte përqendruar në komuna ku ishin mbajtur takime me kryetarët e komunave, kryetarët e gjykatave komunale, kryetarët e gjykatave për kundërvajtje, si dhe komandantët, zëvendësit apo përfaqësuesit e stacioneve policore të nivelit komunal. Gjithashtu ishin zhvilluar shuma intervista me gazetarë të radiove, TV dhe gazetave.

Gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur disa ndryshime në përbërjen e Panelit dhe Sekretariatit. Gjykatësi i parë dhe anëtari zëvendësues i EULEX-it, z. Francesco Florit dhe përkatësisht znj. Gabrielle Gaube kanë dhënë dorëheqje nga Paneli, dhe pastaj janë emëruar anëtarë të rinj gjyqtarësh dhe anëtarë zëvendësues të EULEX-it si në vijim: znj. Esmë Erterzi (më vonë ka dhënë dorëheqje), znj. Anna Bednarek dhe znj. Verginia Micheva-Ruseva. Gjithashtu Paneli ka punësuar znj. Stephanie Selg, zyrtare ligjore në qershor të vitit 2011.

## 2. Rregullorja e punës

Duke pasur parasysh përvojën praktike të procedurave të Panelit në punën e saj deri më tani, me datën 21 nëntor 2011 Paneli ka ndryshuar dhe shtuar Rregulloren e Punës (RrP) në mënyrë që t'i thjeshtëzoj procedurat në zbatimin e tyre praktik.

Për ta qartësuar Rregulloren 25.1 të RrR, Paneli ka vendosur që duhet të sqarojë se nuk është organ i apelit në lidhje me procedurat gjyqësore pranë gjykatave të Kosovës. Ai përmbushi këtë kërkesë me futjen e fjalëve: “Me shqyrtimin e konceptit për llogaridhënie në Planin Operativ (OPLAN) të EULEX-it në Kosovë” në Rregulloren 25.1 e cila tani shkruan si në vijim:

*“Çdo person mund të parashtrij ankesë, përveç personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili deklaron se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv. Në shqyrtimin e konceptit llogaridhënës të Planit Operativ (OPLAN) të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk do të shqyrtoj procedurat gjyqësore të gjykatave në Kosovë”.*

Paneli më herët ka kuptuar se dispozita në Rregulloren 25.3 ku thuhet se ankesat duhet të dorëzohen në Panel brenda tre muajve nga data kur Paneli mund të pranoj ankesa, është pjesërisht e pavlefshme. Data kritike në këtë rast ishte 10 qershori 2010, datë kur Paneli kishte filluar punën. Kështu, ky element u bë i pavlefshëm tre muaj më vonë më 10 shtator 2010. Prandaj Rregullorja 25.3 ishte ndryshuar për t'iu qasur kësaj çështje dhe tani shkruan si në vijim:

*“Ankesat duhet t'i paraqiten Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar”.*

Paneli gjithashtu ka identifikuar nevojën për një dispozitë që të mundësoj heqjen e një ankese nga lista nëse gjatë procedurave është vërejtur se parashtruesi i ankesës nuk ka dëshiruar që të vazhdoj me shqyrtimin e procedurës, apo nëse Paneli ka vendosur se për arsye të tjera vazhdimi i shqyrtimit do të ishte i paasyetshëm. Për më tej, në përputhje me parimet e përgjithshme të të drejtave të njeriut, Paneli do të vazhdoj që të shqyrtoj ankesën nëse bëhet e nevojshme për shkak të respektimit të të drejtave të njeriut.

Kështu Paneli ka krijuar Rregulloren e re 29 shtesë, që shkruan si në vijim:

*1. “Në çdo fazë të procedurave, Paneli mund të vendos të heq ndonjë ankesë nga lista e rasteve atëherë kur rrethanat shpijnë në përfundim se:*

- a. Parashtruesi i ankesës nuk ka ndërmend që të vazhdoj tutje ankesën e tij/saj; apo*
- b. Për çfarëdo arsye tjetër të vërtetuar nga Paneli, nuk është e arsyeshme që të vazhdohet tutje me shqyrtimin e ankesës”.*

*2. “Paneli do të vazhdoj shqyrtimin e ankesës nëse bëhet e nevojshme për shkak të respektimit të të drejtave të njeriut”.*



Për më tej, Paneli ka krijuar Rregulloren e re 45 shtesë për të mundësuar që të përcillet zbatimi i rekomandimeve nga Shefi i Misionit (ShM) dhe për të publikuar vendimet shtesë. Kjo rregullore e re thotë si në vijim:

- 1. Pasi Paneli t'i ketë bërë rekomandimet për veprime korrigjuese, Paneli do të përcjell zbatimin e rekomandimeve nga ShM.*
- 2. "Vendimi i Panelit për zbatimin e rekomandimeve nga ShM do të publikohet menjëherë në [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe".*

### **3. Paneli dhe Sekretariati**

#### ***3.1. E përgjithshme***

Gjatë periudhës raportuese, ka pasur ndryshime në përbërjen e personelit të Panelit. Këto ndryshime përfshinë largimin e znj. Gabrielle Gaube, një gjykatëse ndërkombëtare e EULEX-it dhe anëtare zëvendësuese e Panelit e cila kishte përfunduar detyrën e saj në EULEX më 31 dhjetor 2010. Z. Francesco Florit, anëtar i Panelit kishte dhënë dorëheqje nga Paneli për tu emëruar Kryetar i Asamblesë së gjykatësve të EULEX-it më 17 prill 2011.

Këto largime kanë bërë të nevojshme që të emërohet z. Esma Erterzi si anëtare e Panelit më 27 maj 2011. Znj. Anna Bednarek ishte emëruar si anëtare zëvendësuese për ta zëvendësuar znj. Erterzi më 27 maj 2011. Znj. Erterzi kishte dhënë dorëheqje nga Paneli më 2 qershor 2011 dhe ajo ishte zëvendësuar si anëtare e Panelit nga znj. Bednarek më 28 qershor 2011. Znj. Verginia Micheva-Ruseva ishte emëruar më 28 qershor 2011 si anëtare zëvendësuese për ta zëvendësuar znj. Bednarek në atë cilësi në Panel. Paneli gjithashtu kishte marrë në punë znj. Stephanie Selg si zyrtare të dytë ligjore në qershor 2011.

#### ***3.2. Anëtarët e Panelit***

**Z. Antonio Balsamo**, shtetas italian, ka diplomuar për Drejtësi në Fakultetin e Jurisprudencës, Universiteti i Palermos në Itali në dhjetor 1986. Ai specializoi në të Drejtën e Pushtetit Rajonal dhe Lokal në Universitetin e Palermos në vitin 1991.

Ai punoi si gjykatës në Gjykatën e Palermos nga viti 1995-2007 ku u mor me shqyrtimin e shumë lëndëve të rëndësishme, përfshirë këtu edhe gjykimin e Giulio Andreotti lidhur me marrëdhëniet e ndërlikuara që ekzistonin mes krimit të organizuar dhe institucioneve publike. Z. Balsamo ishte kryesues i Gjykatës e cila urdhëroi konfiskimin e pasurive, që u vlerësuan qindra miliona euro, të Mafisë së Sicilisë në vitin 2002.

Z. Balsamo është i punësuar në Gjykatën Supreme të Kasacionit në Itali prej vitit 2007 deri në shtator 2011. Ai ishte përgjegjës për trajnimin profesional të gjykatësve dhe prokurorëve të Gjykatës Supreme të Italisë.

Në shtator 2011 z. Balsamo ishte emëruar Kryetar i Seksionit të Parë të Gjykatës së Assize të Caltanissetta, kompetente për gjykimet në lidhje me krimet më të rënda të kryera në qarkun qendror të Sicilisë dhe vrasjet e gjykatësve dhe prokurorëve me punë në Palermo. Gjithashtu ai kryeson Gjykatën që është përgjegjëse për konfiskimin e pasurisë që i përkasin grupeve mafioze.

Ai është anëtar i Komitetit Rajonal Shkencor i Institutit Ndërkombëtar të Studimeve të Larta në Shkencën Penale, anëtar i Këshillit Udhëheqës të Shoqatës së gjykatësve të Italisë, drejtor i revistës “*La Magistratura*” si dhe anëtar i Komisionit Shkencor i revistës “*Archivio Penale*”. Ai gjithashtu është profesor i së drejtës penale në shkollën e specializimit pasuniversitar për profesionin juridik.

Z. Balsamo është ekspert gjyqësor i së drejtës evropiane, të drejtave të njeriut dhe bashkëpunimit juridik ndërkombëtar rreth çështjeve kriminale. Ai ishte edhe anëtar i Këshillit Shkencor në Këshillin e lartë italian për Gjyqësi dhe i Komisionit për Reformimin e Ligjit Penal të Italisë. Ai gjithashtu mori pjesë si konsulent ekspert në projektet e Bashkimit Evropian që kishin të bënte me reformimin e ligjit penal të Bullgarisë, si the themelimin e Zyrës së Prokurorit Publik për t’u përballë me krim të organizuar dhe korrupsion në IRJM dhe trafikim me qenie njerëzore në Turqi.

Ai ka edituar librin “*Giurisprudenza europea e processo penale italiano*” (Jurisprudenca Evropiane dhe procesi penal italian) mbi praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ndikimin e saj në ligjin e Italisë për procedurën penale. Ai gjithashtu ka botuar një libër mbi dëshmitë nga thashethemet dhe mbi masat anti-mafia, si dhe disa artikuj në revistat e specializuara shkencore dhe kaptina librash mbi tema të ndryshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivelin shtetëror dhe ndërkombëtar.

**Znj. Magda Mierzewska**, shtetase polake, ka kaluar me sukses Provimin Shtetëror të Polonisë për poste gjyqësore në vitin 1982. Ajo u pranua në Odën e Këshilltarëve Juridik të Gdanskut në vitin 1989 dhe ka arritur shkallën e magjistrisë të drejtësisë (LLM) në të Drejtën e Bashkimit Evropian në Universitetin Leicester në vitin 2005.

Ajo u emërua Avokate në Sekretariatën e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në Strasburg në vitin 1993. Pastaj, nga viti 1998 ajo ishte punësuar si juriste në Sekretariatën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo ka përvojë të gjerë ndërkombëtare të trainimit në çështje të ndryshme thelbësore dhe procedurale të të drejtave të njeriut.

Publikimet e shumta akademike të znj. Mierzewska përfshijnë: Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut: Dhjetë vite pas Ratifikimit, Zyra për Informim e Këshillit të Evropës në Varshavë, 2004; Pas dhjetë viteve: Popullariteti i Konventës në Poloni (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, botimi i 4, 2004; Pas dhjetë viteve: Praktika gjyqësore polake voluminoze dhe interesante (bashkë-autore), Revista e Ligjeve Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Botimi 5, 2004; Standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të KEDNj në Rastet lidhur me shpronësimet dhe aplikimin e tyre për kërkesat pronësore Gjermane, Instituti Polak për Marrëdhënie të Jashtme, 2005; Procesi i pranimit të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut në Poloni dhe

Slovakia në: Pranimi i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, eds. H. Keller, A. Stone-Sweet, Oxford University Press, maj 2008.

**Znj. Anna Bednarek** ka diplomuar në Universitetin e Gdanskit në Poloni në nivelin e magjistrit të drejtësisë (LLM) në vitin 1994, kurse ajo ka kaluar provimin shtetëror të Polonisë për postet gjyqësore në vitin 1997. Ajo përfundoi studimet e saj pasuniversitare si gjyqtare civile në Akademinë e Shkencave të Polonisë në Varshavë, si dhe studimet e saj pasdiplomike në Institutin e Shkencës së Vendeve në zhvillim në Universitetin e Varshavës me disertacionin rreth Kartës Afrikane të të Drejtave të Njeriut dhe Popujve në 2008/2009.

Znj. Bednarek ka punuar si eksperte e lartë në zyrën e agjentit të Qeverisë së Polonisë në Komisionin Evropian dhe në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut, në Divizionin e të Drejtave të Njeriut dhe Pakicave Kombëtare, Departamentin Ligjor dhe Traktat të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Polonisë në Varshavë, dhjetor 2007. Gjithashtu ajo ishte anëtare e Delegacionit të qeverisë së Polonisë për seancën e 54-të të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në vitin 1998.

Znj. Bednarek ishte emërua si gjykatëse në gjykatën e qarkut në Varshavë në qershor të vitit 1998, ku shërbeu deri në vitin 2001, dhe pastaj ajo ishte punësuar si Konsull në Ambasadën e Polonisë në Romë, Itali nga viti 2001 deri në vitin 2007.

Ajo ka punuar si gjykatëse në gjykatën e qarkut në Varshavë, (Sąd Rejonowy dla Warszawy-Śródmieścia w Warszawie) nga prilli i vitit 2007 deri në janar të vitit 2009. Më pas ajo ishte emëruar gjykatëse e EULEX-it në Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, ku ajo punon që prej janarit të vitit 2009.

Në vitin 2008 ajo ka marrë pjesë si trajnuese në “Trafikimi i qenieve njerëzore-Trajnim për gjykatës”. Projekti kishte qëllim të luftonte trafikimin e qenieve njerëzore dhe skllavërinë. Ky projekt ishte organizuar nga Fondacioni La Strada nga Varshava, Poloni, në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të brendshme të Polonisë dhe Ambasadën Britanike në Varshavë.

Znj. Bednarek gjithashtu ka punuar për Amnesty International si menaxhere projekti e një projekti në Poloni për publikimin e një doracaku shkollor për të Drejtat e Njeriut dhe si koordinatore e grupit lobues.

Znj. Bednarek ishte emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) të EULEX-it nga shefi i Misionit të EULEX-it më 25 maj 2011, e pastaj ajo ishte emëruar si anëtare e Panelit nga shefi i Misionit të EULEX-it më 12 korrik 2011.

### *3.3. Anëtare zëvendësuese*

**Znj. Verginia Micheva-Ruseva** u diplomua nga Universiteti i Sofjes në Bullgari në nivelin e magjistrit të drejtësisë në vitin 1995 dhe ajo ka kaluar provimin shtetëror të Bullgarisë për postet gjyqësore në dhjetor 1995. Gjithashtu ajo ka kryer kurse të

ndryshme ligjore, duke përfshirë edhe kurset mbi ligjin e të drejtave të njeriut, për çka ka marrë certifikata.

Ajo ka shërbyer si gjykatëse gjatë gjithë karrierës së saj pesëmbëdhjetë vjeçare profesionale. Ajo filloi karrierën e saj gjyqësore si gjykatëse e re, pastaj ajo më vonë shërbeu si gjykatëse e gjykatës komunale për tetë vjet dhe pastaj u emërua gjykatëse e gjykatës së qarkut nga këshilli i lartë gjyqësor në qytetin e saj.

Në gjykatën komunale dhe në nivelin e gjykatës së qarkut znj. Micheva-Ruseva është marrë me raste civile dhe penale, duke përfshirë shkeljet e të drejtave të njeriut në rastet e diskriminimit të paligjshëm, diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar, ngacmimit seksual, qasjes në informata personale, zbulimit të informatave dhe mjeteve juridike, konfisimit të pasurisë, etj.

Përveç studimeve për të drejtat e njeriut gjatë Magjistraturës, ajo ka përfunduar shumë kurse rreth Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe protokolleve të saj, gjithashtu si gjykatëse e re ajo ka studiuar jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në shtator të vitit 2008 ajo ka marrë pushim të jashtëzakonshme nga gjykata e saj shtetërore pasi u emërua që të shërbej si gjykatëse civile në nivelin e gjykatës së qarkut në Misionin e EULEX-it në Kosovë.

Znj. Micheva-Ruseva ishte emëruar si anëtare zëvendësuese e Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut të EULEX-it nga shefi i misionit të EULEX-it më 6 korrik 2011.

### ***3.4. Ish anëtarët e Panelit***

**Z. Francesco Florit**, shtetas Italian, ka diplomuar për Drejtësi në Universitetin e Triestes në vitin 1988 ku është dekoruar me vendin e parë për disertacionin e tij mbi të drejtën e tatimeve dhe të drejtën tregtare. Ai ka përfunduar një vit studimi në Universitetin e Drejtësisë në Edinburg mbi Gjykatat Britanike, sistemin e të drejtës penale dhe sistemin e të drejtës zakonore mbështetur nga Projekti për juristë të rinjë evropian në vitin 1998. Ai e kreu provimin e jurisprudencës më 1990 dhe punoi si avokat në sektorin e ligjit të punës. Pas studimeve të mëtejshme dyvjeçare, ai e kaloi me sukses edhe provimin për t'u bërë gjykatës në vitin 1992.

Si gjykatës ai u mor me çështjet e së drejtës civile dhe penale për të specializuar më pas në të drejtën penale. Ai punoi si gjykatës ndërkombëtar me UNTAET në Timorin Lindor dhe në Panelin e Veçantë për Krime të Rënda prej vitit 2002 – 2005 ku është marrë me krimet e kryera nga Armata Indoneziane. Ai është dërguar nga Qeveria e Italisë në Misionin për Sundimin e Ligjit të EULEX-it (Komponenti i Drejtësisë) në mars 2008. Që nga fillimi i Kapacitetit Fillestar Operacional më 9 dhjetor 2008 ai ka punuar si gjykatës ndërkombëtar në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë duke u marrë me rastet më të rënda të veprave penale.

**Znj. Gabriele Gaube**, shtetase gjermane, ka diplomuar për drejtësi në Universitetin Trier në Republikën Federale të Gjermanisë në vitin 1990. Pas përfundimit të

studimeve pasuniversitare si dhe provimit të dytë shtetëror, ajo fitoi titullin pasuniversitar në drejtësi në vitin 1993.

Ajo ishte emëruar gjykatëse në Gjykatën Administrative në Berlin në vitin 1993, ku shërbeu deri në delegimin e saj në muajin mars të vitit 1999 në Ministrinë e Drejtësisë në Berlin, Departamenti për Arsim dhe Trainim/Këshilli Shqyrtues. Gjatë delegimit të saj në muajin janar të vitit 2003 ajo u emërua kryegjykatëse e Gjykatës Administrative dhe në muajin dhjetor të vitit 2004 Gjykatëse e Gjykatës së Lartë Administrative.

Në muajin janar 2005, ajo u rikthye në detyrën e saj gjyqësore në Gjykatën e Lartë Administrative në Berlin-Brandenburg (gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së fundit lidhur me legjislacionin e shteteve federale të Berlinit dhe Brandenburgut) ku në muajin janar të vitit 2007 ajo u emërua zëvendëse e kryetarit të trupit gjykues.

Nga muaji nëntor 2008, ajo është në një pushim të jashtëzakonshëm nga Gjykata e Lartë Administrative dhe është dërguar nga Republika Federale e Gjermanisë në misionin e EULEX-it në Kosovë. Aty ajo u emërua gjykatëse ndërkombëtare në Panelin e Apeleve të Gjykatës Supreme për rastet e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Gjykatës për Apele për Ankesat drejtuar Agjencisë Kosovare të Pronës, përkatësisht nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar dhe shefi i misionit të EULEX-it në Kosovë në muajin janar 2009. Në muajin prill 2010 detyrat iu kishin shtuar që ajo të mbulojë edhe proceset civile në përgjithësi si dhe proceset penale lidhur me kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

**Znj. Esma Özkan Erterzi** ka diplomuar për drejtësi në Univesritetin e Izmirit më 9 shtator 1990. Ajo i ka kaluar provimet shtetërore për tu bërë gjykatëse në vitin 1991. Pas trainimit ajo fillimisht ishte marrë me çështjet penale dhe civile. Pasi që kishte shërbyer shtatë vite në gjykata, ajo ishte emëruar në Drejtorinë e përgjithshme të Ligjit Ndërkombëtar dhe Çështje të jashtme të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Turqisë. Ajo kishte përfaqësuar Ministrinë e Drejtësisë në shumë takime në çështjet e ligjit ndërkombëtar në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ajo ka marrë certifikata nga Universiteti i Ankarasë, Turqi, rreth ligjit të Bashkimit Evropian (BE) dhe të drejtave për pronë intelektuale në vitin 2003. Në të njëjtin vit, ajo kishte marrë bursën Jean-Monnet nga Komisioni Evropian. Në vitin 2004, ajo ka diplomuar në nivelin e magjistratit të drejtësisë (LLM) në Ligjin e Komunitetit Evropian nga Universiteti i Essex, në Mbretërinë e Bashkuar, ku kishte studiuar Konventën Evropiane për të Drejtat e njeriut si dhe Drejtësinë e BE-së si dhe Çështjet e brendshme. Disertacioni i saj i magjistraturës për Drejtësi ishte “Përputhshmëria e Ligjit Evropian rreth Migracionit të paligjshëm me të Drejtën Ndërkombëtare të të drejtave të njeriut”.

Në vitin 2005, ajo ishte emëruar në Zyren e Kryeshefit të Prokurorisë Publike të Gjykatës së Kasacionit si prokurore publike për tu marrë kryesisht me rastet e përdorimit të lëndëve narkotike, tregtisë me lëndë narkotike, tregtisë me drogë, mashtrimeve financiare me çeqe dhe me çështje të tjera që lidhen me çeqe financiare si dhe me çështje ndërkombëtare të Zyrës në fjalë. Ajo ka përfaqësuar Zyrën e Kryeprokurorisë Publike të Turqisë në Samitin Botëror të Prokurorëve të

përgjithshëm në Katar/Doha në vitin 2005, dhe në një Konferencë të Prokurorëve të përgjithshëm evropian nën kornizën e Këshillit të Evropës në Moskë në vitin 2006.

Znj. Erterzi ka marrë pjesë në takimet shqyrtuese midis Komisionit Evropian dhe Republikës së Turqisë rreth Kapitullit 24: “Drejtësi, Liri dhe Siguri” në bisedimet rreth anëtarësimit të Turqisë në Bashkimin Evropian. Ajo ka shërbyer si trainere në seminare të ofruara për gjykatësit dhe prokurorët publik të Turqisë në dokumentin e Kombeve të Bashkuara, i ashtuquajtur Protokollin e Stambollit mbi atë se si të trajtohen akuzat për torturë, si të vlerësohen akuzat për torturë dhe qartësimi i masave mbrojtëse të drejtave të njeriut në Konventat ndërkombëtare.

Ajo është në një pushim të jashtëzakonshëm nga Këshilli i Lartë i Gjykatësve dhe Prokurorëve Publik të Republikës së Turqisë në mënyrë që shërbej si gjykatëse ndërkombëtare në Misionin e EULEX-it që prej majit 2009. Ajo ishte emëruar si gjykatëse ndërkombëtare e Odës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjensinë Kosovare për Mirëbesim.

Znj. Erterzi ishte emëruar anëtare zëvendësuese e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nga Shefi i Misionit të EULEX-it më 10 janar 2011.

### **3.5. Sekretariati**

Sekretariati i Panelit përbëhet prej: një zyrtar i lartë ligjor, dy zyrtare ligjore, një asistente administrative/gjuhësore dhe dy përkthyes.

**Z. John J. Ryan**, shtetas irlandez, ka disponuar për Drejtësi me titullin Bachlor, (Hons) në Drejtësi dhe Studime Evropiane nga Universiteti i Limerick, Irlandë, dhe ai mban diplomë pasuniversitare si avokat nga Shoqata e Avokatëve të Irlandës. Ai ka punuar si avokat me Stephen MacKenzie dhe Co. Solicitors, në Dublin, Irlandë. Ai ka shërbyer në misionet paqeruajtëse me Kombet e Bashkuara në Liban, Siri, Izrael, Kamboxhia, Bosnja Hercegovinë, Kroaci, Maqedoni, Timor Lindor, Nepal, Kosovë dhe në Komisionin Evropian në Kinë. Para se të marrë përgjegjësitë e tij të tanishme ai kishte punuar në UNMIK, ndër të tjera, si Administrator në Komunën e Zveçanit në regionin e Mitrovicës, Shef i Divizionit për Mbështetje Gjyqësore Ndërkombëtare - Departamenti i Drejtësisë, këshilltar ligjor, Zyra e Përfaqësuesit të Veçantë të Kombeve të Bashkuara (O/PSSP) - UNMIK, dhe zyrtar ekzekutiv, Paneli Këshilldhënës i të Drejtave të Njeriut të UNMIK-ut. Ai është emëruar zyrtar i lartë ligjor dhe shef i Sekretariatit të Paneli në prill 2010. Artikulli i tij rreth Panelit Këshilldhënës për të Drejtat e Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ishte publikuar në Revistën e Forcave të Mbrojtjes së Irlandës në vitin 2010.

**Znj. Leena Leikas**, me shtetësi finlandeze, ka diplomuar në shkallën e Magjistratit të Drejtësisë nga Universiteti Turku, në Finlandë dhe pastaj u kualifikuar si gjyqtare. Pas disa viteve në Departamentin e Hartimit të Ligjeve, në Ministrinë e Drejtësisë, ajo ishte punësuar nga Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa në Departamentin Ligjor, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku specializoj në çështjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Nga nëntori i vitit 2007 e deri në prill 2010 ajo ka punuar si avokate për përpunimin e lëndëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë. Ajo është zyrtare ligjor në Sekretariatit të Panelit që nga maji 2010.

**Znj. Stephanie Selg**, me shtetësi zvicerane, ka diplomuar në shkallën e Magjistratit të Drejtësisë nga Universiteti i Bazelit dhe Gjenevës, në Zvicër. Gjatë studimeve, ajo ka specializuar në ligjin humanitar ndërkombëtar dhe ligjin e të drejtave të njeriut, duke marrë një certifikatë të Ligjit Ndërkombëtar nga Universiteti i Gjenevës. Pas praktikës ligjore pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë Administrative të qarkut të Bazelit dhe Gjykatës së Apelit të Bazelit në Zvicër, ajo ishte punësuar nga qeveria e Zvicrës si këshilltare ligjore dhe këshilltare e lartë ligjore në Prandinë e Përkohshme Ndërkombëtare në Hebron (TIPH) në Bregun Perëndimor, Izrael. Ajo ka qenë anëtare e Grupit të Ekspertëve Kombëtar të Zvicrës për ndërtimin e paqes civile që nga viti 2009. Nga tetori i vitit 2010 deri në prill 2011 ajo ka punuar si këshilltare ligjore dhe zyrtare për kërkime në fushën e së drejtës ndërkombëtare pranë Forumit zviceran për të drejtat e njeriut në Bern të Zvicrës. Ajo ishte emëruar si zyrtare ligjore pranë Sekretariatit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në qershor të vitit 2011.

**Znj. Shpresa Gosalci**, shqiptare e Kosovës, ka diplomuar në Universitetin AAB, Prishtinë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ajo ishte punësuar si përkthyes (shqip / serbisht / anglisht) në KFOR nga korriku 1999 deri në qershor 2000, si dhe si asistente administrative/gjuhësore në Zyrën e Informimit Publik dhe Media e Komisionerit të Policisë së UNMIK-ut nga qershori 2000 deri në mars 2009. Ajo është asistente administrative/gjuhësore në Sekretariatit e Panelit që nga korriku 2010.

**Znj. Katica Kovaçević**, serbe e Kosovës, ka qenë e punësuar më parë si asistente administrative/gjuhësore (serbisht / anglisht) në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm nga maji 2003 deri në dhjetor 2008 dhe si asistente gjuhësore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nga janari 2009 deri në nëntor 2010. Ajo filloj punën si përkthyes në Sekretariatit e Panelit në dhjetor 2010.

**Z. Kushtrim Xhaferi**, shqiptar i Kosovës, ka diplomuar në Universitetin e Prishtinës, Kosovë, në degën e gjuhës dhe letërsisë angleze. Ai më parë ka punuar si përkthyes (shqip / anglisht) në Korporatën Energjetike të Kosovës nga shkurti 2004 deri në janar 2009, dhe më pas si asistent gjuhësor në Komponentin e Policisë së EULEX-it. Ai punon si përkthyes në Sekretariatit nga shtatori 2010.

[See Annex No 1. Staff Table](#)

## 4. Veprimtaritë e Panelit

### 4.1. Fushata informuese 2011

Paneli dhe Sekretariatit kanë zhvilluar një plan veprimi për fushatën informuese gjatë vitin 2011. Përveç vazhdimit të fushatës informuese të ngjashme me ato të zhvilluara në vitin 2010, plani i veprimit për vitin 2011 ishte përqendruar tek institucionet komunale.

Kjo janë përfshirë takimet me kryetarët e komunave, kryetarët e gjykatave komunale dhe gjykatave për kundërvajtje si dhe komandantët e stacioneve policore nëpër komuna, apo zëvendësit, përfaqësuesit e tyre. Gjatë vizitave nëpër komuna Paneli dhe

përfaqësuesit e Sekretariatit janë takuar gjithashtu me koordinatorët dhe zyrtarët për të drejtat e njeriut të nivelit komunal, zyrtarët ndërlidhës gjyqësor si dhe OJQ-të e angazhuara në sektorin e të drejtave të njeriut.

Gjatë fushatës informuese të vitit 2011 në takime nëpër komuna është bërë një paraqitje e shkurtër e mandatit, procedurave, funksioneve dhe punës së Panelit si dhe një përmbledhje rreth ligjit në fuqi, sipas së cilës funksionon Paneli. Gjithashtu ka pasur hapësirë për pyetje dhe përgjigje, si dhe diskutime e debate sipas nevojës. Gjithashtu pjesëmarrësve iu ishin ofruar materiale njoftuese rreth Panelit siç janë fletushka dhe posterë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

Pos kësaj, plani i veprimit ka përmbajtur nisjen e fushatës informuese të Panelit për në Serbi me datën 24 dhe 25 janar 2011. Paneli është takuar me ndihmës ministrin, Ministria për Kosovë dhe Metohi në qeverinë e Republikës së Serbisë, ndihmës ministrin, Ministria e Drejtësisë në qeverinë e Republikës së Serbisë dhe me zyrtarët e Këshillit danez për refugjatë, si dhe me kryetarin e Këshillit për personat e humbur dhe të rrëmbyer.

Në përputhje me planin e veprimit që ishte përqendruar nëpër komuna të Kosovës, Paneli ka takuar koordinatorët dhe zyrtarët për të drejtat e njeriut të departamenteve qeveritare dhe komunale në qeverinë e Kosovës të premtën më 8 prill 2011. Ky takim ishte organizuar nga z. Habit Hajredini, koordinatori për të drejtat e njeriut, zyra e kryeministrit në qeverinë e Republikës së Kosovës, i cili gjithashtu kishte bashkëkryesuar këtë takim me znj. Magdalena Mierzevska, anëtare e Panelit. Në këtë takim kishin marrë pjesë përfaqësuesit shtatëdhjetë e pesë (75) koordinatorë dhe zyrtarë për të drejtat e njeriut të nivelit qendror qeveritar dhe të nivelit komunal.

Përveç kësaj, plani i veprimit ishte përqendruar në rininë duke ofruar takime me institucionet shkollore të nivelit të tretë. Paneli u takuar me studentët e fakultetit juridik të Universitetit të Prishtinës më 23 shkurt 2011, si dhe me studentët të Universitetit Amerikan të Kosovës më 6 prill 2011.

Sekretariati gjithashtu u është drejtuar Odës së Avokatëve të Kosovës në “Ditën e Avokatëve” në hotelin Grand në Prishtinë, ku ishin të pranishëm disa qindra avokatë. Për më tej, Paneli dhe Sekretariati kanë marrë pjesë në disa seminare njoftuese rreth të drejtave të njeriut, kanë zhvilluar tre intervista me gazetarë të televizionit, radios dhe gazetës, dhe kanë mbajtur një konferencë për shtyp në vitin 2011.

Në fund, Paneli dhe Sekretariati janë takuar dhe kanë njoftuar studentët të cilët janë në studime të magjistraturës dhe doktoraturës rreth disiplinave më të gjera të të drejtave të njeriut, çështjeve ndërkombëtare, demokratizimit dhe kriminalistikës në grup dhe veç e veç, sipas kërkesës.

### [Shih shtojcën nr. 2 Fushata informuese](#)

#### *4.2. Tainimi hyrës për personelin e EULEX-it*

Gjatë periudhës raportuese Sekretariati ka marrë pjesë në trainime hyrëse për personelin e ri të EULEX-it. Në këto trainime, Sekretariati ofron një paraqitje me



programin power point rreth Panelit, gjithashtu me hapsirë të caktuar për pyetje e përgjigje. Kjo është vërtetuar të jetë, mes të tjerash, një tribunë e dobishme për të njoftuar personelin e ardhshëm rreth mandatit të Panelit dhe për ta bërë më të njohur Panelin në territorin e misionit.

#### **4.3. Faqja e internetit**

Sekretariati mirëmban faqen e internetit të Panelit: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu). Faqja është zgjeruar dhe përmban informacione të dobishme rreth mandatit, funksioneve, veprimtarive dhe punës së Panelit, si dhe komunikatave për shtyp, statusin e tanishëm të rasteve në pritje dhe rasteve të përfunduara. Ajo gjithashtu mban informacione rreth ligjit në fuqi për të drejtave të njeriut, si dhe formularë për ankesa dhe udhëzime për paraqitjen e ankesës në gjuhët angleze, shqipe dhe serbe.

## **5. Ankesat pranë Panelit**

#### **5.1. Numri i lëndëve**

Paneli ka bartur dhjetë (10) lëndë të papërfunduara prej vitit 2010. Janë marrë vendime në të gjitha këto lëndë në vitin 2011, dhe është konstatuar se tri (3) lëndë ishin të papranueshme, njëra ishte e pranueshme dhe gjashtë (6) ishin pjesërisht të pranueshme.

Pas shqyrtimit, Paneli vendosi se në pesë prej këtyre lëndëve nuk ka pasur ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut. Sidoqoftë, Paneli vendosi që EULEX-i ka shkelur dispozita të caktuara të Konventës në dy (2) lëndë: në lëndën nr. 2010-01, z. *Djeljalj Kazagic kundër EULEX-it* dhe në lëndën nr. 2010-07, z. *Blerim Rudi kundër EULEX-it*.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Paneli ka pranuar njëzet e tetë (28) ankesa të reja. Paneli ka marrë njëzet (20) vendime rreth këtyre lëndëve, nëntëmbëdhjetë (19) prej të cilave u konstatuan të jenë të papranueshme, dhe një (1) ankesë ishte hequr nga lista e ankesave. Tetë ankesa janë ende të papërfunduara dhe ato janë bartur për në vitin 2012.

#### **[Shih shtojcën nr.3 Statistikat](#)**

#### **5.2. Shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë**

Paneli ka miratuar mendimin e vet të parë në lëndën *Djeljalj Kazagic kundër EULEX-it* (të cituar më lart) më 8 prill 2011. Paneli ka gjetur se ka pasur një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afatit të arsyeshëm në kundërshtim me Nenin 6.1 të kësaj Konvente. Gjithshtu është gjetur se ka pasur një shkelje të së drejtës së parashtruesit të ankesës për gëzim paqësor të pronës së tij në kundërshtim me Nenin 1, Protokollin 1 të kësaj Konvente.

Paneli ka rekomanduar ShM të ndërmerr këto veprime korrigjuese si në vijim:

- të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për largimin e gjendjes së pasigurisë e cila ndikon në gëzimin paqësor të parashtruesit të ankesës në pronën e tij, në veçanti:

- të ndërmerr një hetim nëse ish-in plotësuar kushtet që rasti civil i parashtruesit të ankesës i cili është marrë përsipër nga gjykatësit e EULEX-it, siç saktësohet në Nenin 5 paragrafi 1 (c) (ii) apo (iii) të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë;
- të jep asyet për çka duket se nuk ka pasur përparim në hetimin që ishte hapur nga prokurori i EULEX-it, si pasojë e kërkesës së parashtruesit të ankesës së datës 25 qershor 2009;
- të shqyrtoj nëse në rrethanat e rastit të parashtruesit të ankesës ish-in plotësuar kushtet e nevojshme që zbatohet kompetenca dytësore e prokurorit të EULEX-it; dhe
- të ndërmerret një hetim se çfarë hapa mund të ndërmerren me ndihmën ose përfshirjen e EULEX-it në mënyrë që të sigurohet zbatimi përfundimtar i vendimit gjyqësor i datës 11 dhjetor 2007.

### **5.3. Veprimet nga EULEX-i në Kosovë në lëndën Kazagic**

ShM njoftoj Panelin rreth veprimeve të ndërmarra nga EULEX-i në lëndën Kazagic me datën 26 tetor 2011, si në vijim:

EULEX-i ka gjetur dosjet e lëndës në Gjykatën Komunale të Mitrovicës dhe ka caktuar një gjykatës të EULEX-it për të zhvilluar një analizë që të përcaktoj se a ish-in plotësuar kushtet që rasti i parashtruesit të ankesës të merrej përsipër nga gjykatësit e EULEX-it.

Pas një shqyrtimi të plotë të materialeve në dispozicion, ishte vendosur nga ana e gjykatësit të caktuar se nuk ish-in plotësuar kushtet e përmendura.

EULEX-i nuk kishte hapur ndonjë hetim prokurorial rreth rastit, pasi ajo ishte hetuar nga një prokuror i Kosovës para se parashtruesi i ankesës ta parashtronte rastin e tij në EULEX.

Edhe pse EULEX-i kishte autoritet ligjor që ta merrte përsipër ndjekjen penale të rastit, kryeprokurori i EULEX-it kishte vendosur që mos ta merrte përsipër lëndën pasi kishte shqyrtuar me kujdes dosjen e lëndës.

Përkundër shqyrtimit të kujdesshëm dhe të hollësishëm nga ana e gjykatësve, prokurorëve të EULEX-it dhe menaxhmentit të lartë të Komponentit të Drejtësisë së EULEX-it, ishte konstatuar se marrja e lëndëve sipas rëndësisë nuk do t'i çonte përpara synimet e EULEX-it, e as nuk do të përmirësonte gjendjen e përgjithshme në sistemin gjyqësor të Kosovës. Prandaj hetimit të kësaj lënde nuk iu ishte dhënë përparësi, jo më pak se për shkakun se ajo do të shkonte në dëm të lëndëve të tjera të pazgjdhura.

Në përfundim, ShM deklaroi se e kupton dhe ndjen keqardhje rreth gjendjes së parashtruesit të ankesës dhe se është në dijeni rreth numrit të madh të lëndëve gjyqësore që janë të pazgjidhura brenda sistemit gjyqësor të Kosovës.

Paneli miratohet mendimin e tij të dytë në lëndën *Blerim Rudit kundër EULEX-it* (të citur më lart) më 8 qershor 2011. U konstatua se kishte pasur një shkelje të së drejtës së parashtruesit të ankesës për gëzim paqësor të pronës së tij në kundërshtim me Nenin 1, protokollin 1 të kësaj Konvente.

Paneli rekomandohet ShM që t'i ndërmerr këto veprime korigjuese, të paraqitura në vijim:

- Duhet të jepet një deklaratë që pranon se rrethanat e këtij rasti përbëjnë shkelje të të drejtave të parashtruesit të ankesës që i ngarkohen veprimeve të EULEX-it gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv; dhe
- Duhet të ndërmerret një hetim rreth masave të veçanta të cilat ShM mund t'i ndërmerr, në mënyrë që t'i jepet fund shkeljes që është konstatuar në këtë rast.

#### **5.4. Veprimet e EULEX-it në Kosovë në lëndën Rudi**

Më 3 gusht 2011 ShM njoftoj Panelin se më 1 korrik 2011 ai kishte kërkuar nga drejtori ndërkombëtar i Qendrës së Inteligjencës Financiare (më tutje si: QIF dhe Drejtori) që të ndërmerr hapa për ta rikthyer z. Rudi në pozitën e tij dhe për të siguruar që atij t'i kompenzohej paga e tij e papaguar. Gjithashtu, ai kishte nxitur Drejtorin të konsideronte tërheqjen e lëndës që ishte në pritje pranë Gjykatës Komunale të Prishtinës kundër z. Rudi.

Për më tej, ShM deklarohet se më 6 korrik 2011 Drejtori zyrtarisht kishte kërkuar që padia në pritje kundër z. Rudi të tërhiqej nga Gjykata Komunale. (Në të vërtetë, lënda në pritje ishte kundër Këshillit të Pavarur Mbikqyrës (më tutje si: KPM) e jo kundër z. Rudi).

Përmes një vendimi me shkrim të datës 13 korrik 2011, z. Rudi ishte kthyer në pozitën e vet të mëhershme deri në përfundimin e kontratës së tij më 31 gusht 2011. Përveç kësaj, pagat që nuk iu ishin paguar z. Rudi, zyrtarisht iu ishin kërkuar Ministrisë së Financave nga ShM, dhe pastaj atij iu ishin paguar.

#### **5.5. Ankesat e zakonshme**

Tek ankesat që janë parashtruar në Panel janë vërejtur disa struktura të dallueshme. Shumica e ankesave pretendojnë në shkelje të Konventas Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) dhe/apo Protokollin e saj. Dispozitat e Konventës të cilat kanë nxitur ankesat janë të paraqitura si në vijim:

- Neni 2 mbi të drejtën për jetë;
- Neni 3 mbi ndalimin e torturës;
- Neni 5 mbi të drejtën për liri dhe siguri;

- Neni 6 mbi të drejtën për gjykim/dëgjim të drejtë brenda afatit të arsyeshëm;
- Neni 8 mbi të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare;
- Neni 10 mbi të drejtën për liri të shprehjes;
- Neni 13 mbi të drejtën për mjete juridike efektive;
- Neni 14 mbi ndalimin e diskriminimit;
- Neni 1 i protokollit 1 i Konventës mbi mbrojtjen e pronës.

#### 5.6. *Subjekti i ankesave*

Llojet më të shpeshta të shkeljeve të pretenduara të të drejtave të njeriut të parashtruara në Panel kanë qenë si në vijim:

- Akuzat për një shkelje të së drejtës për jetë (Neni 2 i Konventës) në lidhje me hetimin e pamjaftueshëm të shkakut të vdekjes së burgosurve të cilët kishin vdekur në incidentin e burgut të Dubravës më 4 shtator 2003. Lëndët *Sadik Thaqi* (2010-02), *Osman Mehmetaj* (2010-03), *Feti Demolli* (2010-04), *Mursel Hasani* (2010-05) dhe *Latif Fanaj* (2010-06).
- Akuzat për një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i Konventës) në lidhje me një shkelje të së drejtës për gëzim paqësor të pronës, Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës. Lëndët *Kazagic Djeljalj* (2010-01), *Blerim Rudi* (2010-07) dhe *Dejan Jovanovic* (2011-10).
- Akuzat për një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë (Neni 6 i Konventës) në lidhje me shkeljet e së drejtës për liri dhe siguri (Neni 29) dhe e drejta për një gjykim të drejtë (Neni 31 i Kushtetutës së Kosovës). Lënda *Burim Ramadani* (2010-09).
- Akuzat për një shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë (Neni 6 i Konventës) së bashku me një shkelje të së drejtës për mjete efektive juridike (Neni 13 i Konventës); shkelja e së drejtës për gëzim paqësor të së drejtës në pronë (Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës) dhe një shkelje e masave mbrojtëse procedurale që kanë të bëjnë me dëbimin e të huajve (Neni 1 i Protokollit 7 të Konventës). Lënda *Chamalagai Krishna Bahadur* (2011-02).
- Akuzat për një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë (Neni 6 i Konventës) në lidhje me një shkelje të së drejtës për liri të shprehjes (Neni 10 i Konventës) Lëndët: *SH.P.K "SYRI"* (2011-05) dhe *Anton Rrukaj* (2011-08).
- Akuzat për një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë (Neni 6 i Konventës) së bashku me një shkelje të ndalimit të torturës (Neni 3 i Konventës) si dhe një shkelje e së drejtës për liri dhe siguri (Neni 5 i Konventës). Lëndët *S.M.* (2011-11) dhe *Novica Trajkovici* (2011-12).
- Akuzat për një shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë (Neni 6 i Konventës) në lidhje me ndalimin e torturës (Neni 3 i Konventës) si dhe një shkelje e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare. Lënda *Slobodan Martinovici* (2011-13).
- Akuzat për një shkelje të ndalimit të diskriminimit (Neni 14 i Konventës). Lënda *Velimir Krstic* (2010-08).

- Akuzat për një shkelje të Nenit 17 (2) të Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut (1948): “Asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij” si dhe një shkelje e së drejtës për gëzim paqësor të pronës (Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës). Lënda *Afrim Mustafa* (2011-03).

## 6. Jurisprudenca e Panelit

Paneli ka zhvilluar edhe më tej jurisprudencën e vet gjatë shqyrtimit të ankesave të dyshuara të shkelje të të drejtave të njeriut. Në fazën e hershme të punës së tij, shqyrtimet e lëndëve nga ana e Panelit ishin drejtuar më së shumti rreth çështjes së pranueshmërisë. Për më tej, ai kishte për qëllim që të përcaktonte jurisprudencën e vet dhe krijimin e kufive. Përpos kësaj, Paneli është marrë gjithashtu edhe me çështje të caktuara thelbësore gjatë fazave të mëvonshme të periudhës raportuese.

### 6.1. Çështjet e pranueshmërisë

Paneli iu ka qasur disa çështjeve të pranueshmërisë, të paraqitura si në vijim:

#### 6.1.2 Afatet kohore për parashtrimin e një ankese

Paneli ka filluar punën pas miratimit të RrP së vet më 10 qershor 2010 dhe në atë datë ishte vendosur dita kur Paneli ishte i autorizuar që të pranonte ankesa.

Shpeshherë ankesat nuk ishin parashtruar brenda afatit përkatës siç përcaktohet në Rregulloren 25 (3) të RrP ku thuhet se:

*“Ankesat duhet t’i dorëzohen Panelit brenda tre muajve nga data kur Paneli mund të pranoj ankesat, apo brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar, cilado që është e përshtatshme për ankuesin”.*

Ankesat e tilla janë konsideruar të jenë të papranueshme sipas dispozitave të Rregullores 25 (3). Lëndët *Blakqori* (2011-06), *S.M.* (2011-11), *Trajkovic* (2011-12), *Martinovic* (2011-11) and *Gashi* (2011-22).

#### 6.1.3 Pranueshmëria *ratione personae*

Ankesat që ishin parashtruar në Panel lidheshin me veprime të dyshuara të kryera nga organe të cilat nuk përbënin mandatin ekzekutiv të EULEX-it. Rregullorja 25 (1) e Rregullores së Punës së Panelit, ndër të tjerash, thotë si në vijim:

*“Çdo person mund të parashtroj ankesë, përveç personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili/cila pretendon se është vikatimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë përmbushjes së mandatit të tij ekzekutiv ....”*

Pra, ankesat duhet të kenë lidhje me një veprim apo lëshim nga EULEX-i gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Akuzat kundër zyrës së burimeve njerëzore të

EULEX-it janë përjashtuar nga kjo rregullore, pasi çështjet që kanë të bëjnë me punësimin apo largimin e punëtorëve nga puna nuk bie në kuadër të mandatit ekzekutiv të misionit. Lëndët *Proetel* (2010-10), *Pasuli* (2010-12), *Një punëtor i EULEX-it* (2010-13), *Gashi* (2010-14), *Sefa* (2010-15) dhe *Mirkovic* (2011-09).

Ankesa të ngjashme janë ngritur kundër institucioneve dhe personale të ndryshëm publik/privat. Lëndët *Rudi* (2010-11), *Sefa* (2010-15), *Mustafa* (2011-03), dhe *Azemi* (2011-17). Ishte konstatuar se të gjitha këto ankesa ishin jashtë kompetencave të Panelit.

#### **6.1.4 Procedurat gjyqësore pranë gjykatave të Kosovës**

Edhe më tej, Paneli është i kufizuar sa i përket pranueshmërisë, lidhur me atë se e nuk mund të shqyrtoj procedura gjyqësore të gjykatave të Kosovës, në përputhje me dispozitat e OPLAN (PLANIT OPERATIV) të EULEX-it në Kosovë. Paneli nuk mund të veproj si gjykatë e apelit kundër vendimeve të lëshuara nga gjykatat në Kosovë. Prandaj, në Rregulloren 25 (1) e RrP së Panelit, ndër të tjerash, thuhet si në vijim:

*“Paneli nuk do të merret me shqyrtimin e procedurave gjyqësore të gjykatave në Kosovë”.*

Paneli në disa prej lëndëve ka konstatuar se “nuk ka pasur kompetenca lidhur me aspektin administrativ dhe gjyqësor të punës së gjykatave të Kosovës”.

Si pasojë, Paneli ka konstatuar se lëndët nuk bien në kuadër të mandatit ekzekutiv atëherë kur shkeljet e të drejtave të njeriut janë shkaktuar me vendime ose procedura gjyqësore. Lëndët *Gecaj* (2011-01), *SH.P.K “SYRI”* (2011-05), *Blakqori* (2011-06), *Rruka* (2011-08), *Jovanovic* (2011-10), *Shabani* (2011-14), *Smajli* (2011-15) dhe 2011-16, *Gashi* (2011-22), *Lazic* (2011-24) dhe *Asllani* (2011-26).

## **6.2 Çështjet thelbësore**

Paneli gjithashtu është marrë me disa çështje thelbësore, të cilat janë përshkruar si në vijim:

### **6.2.1 E drejta për gjykim të drejtë (Neni 6 (1) i Konventës)**

#### **Lënda nr. 2010-01 Djelalj Kazagic kundër EULEX-it**

Është kërkuar që Paneli të shqyrtoj nëse mos zbatimi i një vendimi detyrues ligjor i Gjykatës Komunale i datës 14 dhjetor 2007 kishte shkelur të drejtën e parashtruesit të ankesës për një gjykim të drejtë ashtu siç garantohet me Nenin 6 të Konventës në lëndën *Djelalj Kazagic kundër EULEX-it* (2010-01).

Prona e parashtruesit të ankesës ishte shfrytëzuar pa dijen apo pëlqimin e tij si hipotekë për një kredi bankare e cila ishte marrë nga një palë e tretë. Kjo palë nuk kishte paguar kredinë, prandaj banka kishte filluar që të ekzekutoj procedurat

përmbartimore për t'i rithyer asetet e veta. Vendimi gjyqësor për të hequr gjendjen e hipotekës, pasi që prona vazhdonte që të ishte në listën e hipotekës, dhe se përpjekjet e parashtruesit të ankesës për të regjistruar këtë status siç duhet ishin të pasuksesshme.

Më 25 qershor 2009 parashtruesi i ankesës ka kërkuar nga një prokuror i EULEX-it që të vazhdoj me një hetim penal dhe ndjekje penale rreth kësaj çështje, e që kjo kërkesë i referohej edhe procedurave civile. Paneli vendosi se sa i përket afatit kohor pasi që ankesa në fjalë ishte parashtruar më 2 shtator 2010, ajo ishte e pranueshme në përputhje me Rregulloren 25(3) të RrP.

Paneli konstaton se vendimi i Gjykatës Komunale i datës 14 dhjetor 2007 ishte përfundimtar dhe detyrues dhe se autoritetet deri më tani nuk kishin arritur që të merrnin ndonjë hap për të zbatuar atë vendim në të mirë të parashtruesit të ankesës, përkundër kërkesave të përsëritura nga ai për këtë qëllim.

Paneli kishte nënvizuar edhe një herë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut (Gjykata) se e drejta për qasje në gjykatë e garantuar me Nenin 6 (1) të Konventës do të jetë iluzion nëse sistemi ligjor i vendit do ta lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe ligjor të mbetej i pazbatueshëm në dëm të njërës palë.

Paneli vazhdoj të thonte se ekzekutimi i një vendimi i marrë nga çfarëdo gjykate duhet të cilësohet si pjesë përbërëse e “grykimit” për qëllimet e Nenin 6 të Konventës (shih, në mes të shumë autoriteteve të tjera, *Hornsby kundër Greqisë*<sup>1</sup>).

Paneli konsideron se edhe pse problemet e hasura nga parashtruesi i ankesës fatkeqësisht ishin të zakonshme, posaçërisht në rajonin e Mitrovicës, ky faktor nuk e shfaqëson personin përgjegjës të detyrës për të zbatuar kërkesat siç janë të përcaktuara me Nenin 6 të Konventës në lidhje me ekzekutimin e vendimeve përfundimtare gjyqësore.

### ***6.2.2 E drejta për mbrojtjen e pronës (Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës)***

#### **Lënda nr. 2010-01 Djelalj Kazagic kundër EULEX-it**

Paneli ishte kërkuar që të shqyrtoj nëse e drejta e parashtruesit të ankesës për gëzim paqësor të pronës së tij të garantuar me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës ishte shkelur nga mos ekzekutimi i një vendimi detyrues ligjor i Gjykatës Komunale i datës 14 dhjetor 2007 (Lënda *Djelalj Kazagic kundër EULEX-it*, të cituar më lart).

Paneli konstaton se koncepti i “pronësisë” brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës ka pasur një kuptim autonom, që nuk ishte kufizuar vetëm në pronësi të mallrave fizike dhe se ishte i pavarur nga klasifikimi formal i legjislacionit vendor. Disa të drejta dhe interesa të tjerë që përbëjnë asetet mund që gjithashtu të cilësohen “pronësi” për qëllimet e kësaj dispozite.

---

<sup>1</sup> Hornsby kundër Greqisë, vendim i datës 19 mars 1997, Reportet 1997-II, fq. 510-11, §§ 40 etj.

Paneli konstaton se çështja që duhej të shqyrtohej ishte nëse rrethanat e këtij rasti, në tërësinë e tyre, që i janë dhënë aplikantit, dhe që i nënshtrohen një interesi thelbësor, janë të mbrojtura me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës (shih *Iatridis kundër Greqisë*<sup>2</sup>, *Beyeler kundër Italisë*<sup>3</sup> dhe *Broniowski kundër Polonisë*<sup>4</sup>).

Në përgjigje të argumentit të ShM se nuk ka pasur shkelje të së drejtës së parashtruesit të ankesës, Paneli nënvizoj edhe një herë praktikën gjyqësore të Gjykatës për atë se pamundësia që të ekzekutohet një vendimi përfundimtar gjyqësor në të mirë të aplikantit përbën një shkelje të së drejtës për gëzim paqësor të pronës, (shih *Burdov kundër Rusisë*<sup>5</sup>).

Paneli deklaron se gjatë vlerësimit të zbatueshmërisë së Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës, Gjykata përveç kësaj ka kryer një hetim të përgjithshëm të interesave të ndryshëm që janë rrezik, duke pasur parasysh se Konventa kishte për qëllim që t'i mbroj të drejtat që janë “praktike dhe efektive”.

Në këtë kontekst është theksuar nga Gjykata se pasiguria, qoftë ligjore apo administrative ose që del nga praktikat që zbatohen nga autoritetet zyrtare, ishte një faktor që duhej të merrej parasysh në vlerësimin e punës së autoriteteve zyrtare.

Në të vërtetë, kur një çështje me interes të përgjithshëm është në rrezik, është detyrë e autoriteteve publike që të veprojnë në kohën e duhur, në mënyrën e duhur dhe në vazhdimsi (shih *Beyeler kundër Italisë*<sup>6</sup>, *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*<sup>7</sup> dhe *Plechanow kundër Polonisë*<sup>8</sup>).

Paneli konstatoi se edhe pse parashtruesi i ankesës nuk ka humbur kontrollin e pronës në fjalë, e drejtë për të kontrolluar atë dhe për të gëzuar atë në mënyrë paqësore ishte shkelur, sepse prona ishte shfrytëzuar si hipotekë për një kredi bankare që ishte marrë nga pala e tretë pa dijeninë e tij. Përveç kësaj, pala e tretë nuk kishte paguar kredinë dhe kështu banka kishte nisur procedurat gjyqësore për t'i rithyer asetet e veta.

Së fundi, nuk ishte ekzekutuar vendimi gjyqësor që statusi i hipotekës në atë pronë të hiqej pasi ajo vazhdonte të shënohej si hipotekë, kurse përpjekjet e parashtruesit të ankuesës për ta regjistruar këtë pronë siç duhet ishin të pasuksesshme.

Rrjedhimisht, Paneli konstaton se pasiguria ligjore i ka rrezikuar të drejtat e parashtruesit të ankuesës, dhe kështu ka vendosur se ka pasur shkelje të së drejtës së tij në gëzimin paqësor të pronës së tij sipas dispozitave të Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

## **Nr. i lëndës 2010-07 Blerim Rudi kundër EULEX-it**

<sup>2</sup> *Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 54;

<sup>3</sup> *Beyeler kundër Italisë* [GC], nr. 33202/96, § 100, KEDNj 2000-I;

<sup>4</sup> *Broniowski kundër Polonisë* [GC], nr. 31443/96, § 129, KEDNj 2004-V.

<sup>5</sup> *Burdov kundër Rusisë*, nr. 59498-00, § 40, KEDNj 2002-III;

<sup>6</sup> *Beyeler kundër Italisë* [GC], nr. 33202/96, § §§ 110 përmbledhje, 114 dhe 120 përmbledhje, KEDNj 2000-I;

<sup>7</sup> *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, nr. 48553/99, §§ 97-98, KEDNj 2002-VII;

<sup>8</sup> *Plechanow kundër Polonisë*, nr. 22279/04, § 102, 7 korrik 2009;



Gjithashtu ishte kërkuar nga Paneli që të shqyrtonte nëse e drejta e parashtruesit të ankesës për gëzim paqësor të pronës së tij të garantuar me Nenin të Protokollit 1 të Konvetës ishte shkelur nga mos zbatimi i vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikqyës (KPM) në lëndën *Blerim Rudi kundër EULEX-it* (2010-07).

#### ***Parathënie***

Z. Rudi ishte emëruar zëvendës drejtor i Qendrës së Inteligjencës Financiare (QIF) pas një konkursi më 1 shtator 2008. Kontrata e tij e punës ishte ndërprerë më 28 janar 2010, dhe ai kishte parashtruar një ankesë kundër largimit të tij nga puna tek KPM më 19 shkurt 2010. Më 10 gusht 2010 KPM kishte marrë një vendim përfundimtar dhe detyrues administrativ që z. Rudi duhej të rikthehej në pozitën e tij të punës. QIF vendosi ta pezulloj zbatimin e vendimit bazuar në sugjerimet e tyre se ajo do të ishte në kundërshtim me interesin publik.

#### ***Vërejtjet e ShM të EULEX-it***

Në vërejtjet e tij, ShM nuk ka kontestuar faktet e paraqitura nga parashtruesi i ankesës dhe ato të përmbledhur nga Paneli. Gjithashtu ai pranoi se Neni 6 (1) i Konventës për rrethanat e rastit ishte i zbatueshëm.

Ai vuri në dukje se megjithatë vendimi i datës 10 guht 2010 nga KPM ishte një vendim përfundimtar administrativ i cili i nënshtrohej shqyrtimit gjyqësor në përputhje me ligjin në fuqi. Një rishikim i tillë ishte iniciuar nga QIF dhe se çështja ishte e pazgjidhur në Gjykatën Komunale të Prishtinës.

ShM pranoi se procedurat gjyqësore të pazgjidhura nuk e kishin penguar zbatimin e vendimit përfundimtar të KPM, e cila kishte urdhëruar rikthimin e parashtruesit të ankesës në pozitën e tij të punës.

Megjithatë, në vërejtjet e tij shtesë, ShM deklaroi se Ligji nr. 03/L-192 mbi Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili kishte zëvendësuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës të datës 22 dhjetor 2001 që rregullon çështjet përkatëse, nuk ishte i zbatueshëm në rastin e parashtruesit të ankesës. Ishte e diskutueshme nëse vendimi i KPM ishte marrë në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut në fjalë, përderisa Ligji nr. 03/L-192 kishte hyrë në fuqi më 31 gusht 2010.

Më tej ShM deklaroi se QIF kishte konsideruar se rikthimi i parashtruesit të ankesës në pozitën e tij të mëparshme do të ishte në kundërshtim me interesin publik, në dëm të buxhetit të Kosovës dhe mbrojtjes së besueshmërisë së të dhënave të ndjeshme të mbledhura nga QIF. Mbi këtë bazë QIF kishte vendosur që mos ta rikthej parashtruesin e ankesës në pozitën e tij të mëparshme, mirëpo që përkohësisht ta pezulloj ekzekutimin e vendimit për rikthimin e tij në pozitën e mëparshme për shkak të interesit të publikut, në mënyrë që ta mbroj buxhetin e Kosovës si dhe dokumentet dhe informatat e besueshme të QIF.

Në thelb, QIF kishte konsideruar në atë fazë të procedurës rikthimi i tij në pozitën e mëparshme nuk ishte i detyrueshëm dhe vendosi të pres rezultatin e shqyrtimit gjyqësor.

ShM ia kishte lënë Panelit për të përcaktuar nëse arsyet e ngritura nga QIF ishin të mjaftueshe për të arsyetuar vendimin e tij që mos ta ekzekutoj vendimin për rikthimin e parashtruesit të ankesës në pozitën e tij të mëparshme.

Për më tej ShM ishte i mendimit se refuzimi i QIF për të bërë ashtu nuk përbënte ndonjë shkelje të Nenit 6 të Konventës përderisa vendimi ishte në procedurë gjyqësore.

Sa i përket ankesës sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, ShM vuri në dukje se një “ankesë” mund të paraqes një “posedim” sipas Nenit në fjalë, në qoftë se ajo do të ishte mjaft e bazuar për tu zbatuar. Ai iu referua vendimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në rastin *Burdov kundër Ruisisë*<sup>9</sup>.

Në analizën përfundimtare, ShM ka konsideruar se Neni 1 i Protokollit 1 nuk ishte shkelur në rastin në fjalë, sepse vendimi përfundimtar administrativ ishte duke u shqyrtuar në gjykatë dhe se zbatimi i tij do të ishte në kundërshtim me interesin publik, buxhetin e Kosovës dhe mbrojtjen e besueshmërisë së të dhënave të QIF.

### ***Vërejtjet e Panelit***

Në fillim Paneli vendosi se çështja që duhej të shqyrtohej ishte nëse rrethanat e rastit, në tërësinë e tyre, që i janë dhënë aplikantit, dhe që i nënshtrohen një interesi thelbësor, janë të mbrojtura me Nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës (shih *Beyeler kundër Italisë*<sup>10</sup> dhe *Broniowski kundër Polonisë*<sup>11</sup>).

Sa i përket konceptit të “pronësisë”, Paneli vuri në dukje se kjo shprehje kishte një kuptim autonom, i cili nuk kufizohej vetëm në pronësinë e mallrave fizike dhe ishte e pavarur nga klasifikimi formal i legjislacionit vendor, (shih lëndën *Kazagic* të përmbledhur më lart). Paneli konstatoi se disa të drejta dhe interesa të cilat përbëjnë asete mund që gjithashtu të cilësohen si “të drejta pronësore” dhe kështu si “pronësi” për qëllimet e Nenit 1 apo Protokollit 1 të Konventës.

Paneli vuri në dukje se vendimi administrativ i marrë nga KPM për ta rikthyer parashtruesin e ankesën në pozitën e tij të mëparshme ishte përfundimtar dhe detyrues dhe se tek ai kishte shkaktuar një pritshmëri të ligjshme se ai vendim do të ekzekutohej, para vendimit përfundimtar të ligjshmërisë së ndërprerjes së kontratës së tij të punës, e cila duhej të përcaktohej në një kohë të duhur përmes shqyrtimit gjyqësor. Një pritshmëri e tillë bie në kuadër të nocionit “pronësitë”.

Përderisa ShM parashtrroi se zbatimi i vendimit të datës 10 gusht 2010 nuk ishte e detyrueshme, Paneli ripërsëriti çështjen se kërkesa e parë dhe më e rëndësishme sipas Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës ishte se çdo shkelje nga një autoritet publik në gëzimin paqësor në pronën e dikujt duhet të jetë i ligjshëm.

<sup>9</sup> *Burdov kundër Ruisisë*, nr.. 59498/00, KEDNj 2002-III.

<sup>10</sup> *Beyeler kundër Italisë*, nr. 33202-96, 5 janar 2000

<sup>11</sup> *Broniowski kundër Polonisë*, nr. 31443/96, 22 qershor 2004

Fjalja e dytë e paragrafit të parë të Nenit 1 të protokollit 1 të Konventës ka autorizuar privimin e pronësisë “i nënshtrohet kushteve të përcaktuara me ligj” vetëm dhe paragrafi i dytë ka pranuar se Shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës duke zbatuar “ligjet”. (shih *Ish mbreti i Greqisë dhe të Tjerët kundër Greqisë*<sup>12</sup>).

Neni 1 i Protokollit 1 të Konventës gjithashtu ka kërkuar që privimi i pronësisë duhet të jetë në interes të publikut dhe se ajo duhet të ketë një qëllim legjitim përmes mjeteve të cilat ishin proporcionalisht të arsyeshme me qëllimin që kërkohet të realizohet. (shih *Jahn dhe të Tjerët kundër Gjermanisë*<sup>13</sup>).

Rrjedhimisht, çdo shkelje e tillë duhej të arrinte një “ekuilibër të drejtë” midis kërkesave të interesit të përgjithshëm publik të komunitetit dhe kërkesave themelore për mbrojtjen e të drejtave themelore individuale. Ky ekuilibër i drejtë nuk do të ishte arritur atëherë kur personi në fjalë duhej të mbajnte barrë individuale dhe të tepërt. (shih *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*<sup>14</sup>).

Për më tepër, Paneli konstatoj se parimi i “qeverisjes së mirë” kërkon që atëherë kur interesi i përgjithshëm dhe publik është në rrezik, është detyrë e autoriteteve publike të veprojnë në kohën e duhur, në mënyrën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme. (shih *Beyeler kundër Italisë*<sup>15</sup> dhe *Megadat.com S.r.l. kundër Moldavisë*<sup>16</sup>).

Lidhur me këtë, Paneli vuri në dukje se drejtori i QIF, duke vepruar sipas këshillës nga EULEX-i, pengoi parashtruesin e ankesës që të rifilloj punën në QIF, përkundër vendimit përfundimtar të QIF që ai të rikthehej në pozitën e tij të mëparshme. Ngjashëm Paneli vuri në dukje se QIF nuk ka paguar pagën e parashtruesit të ankesës nga data 28 shkurt 2010 e tutje sipas vendimit të KPM.

Në përfundim, Paneli ishte i kënaqur që refuzimi i QIF për të zbatuar elemente të ndryshme të vendimit të KPM përbëjnë një shkelje të së drejtës së parashtruesit të ankesës në gëzimin paqësor të pronës së tij.

### ***Shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimit të QIF***

Paneli më tej ka shqyrtuar nëse mos zbatimi i vendimit të KPM i datës 10 gusht 2010 nga ana e QIF ishte i ligjshëm, nëse i ka shërbyer publikut dhe interesit publik dhe nëse ka prekur ekuilibrin e drejtë mes interesave të komunitetit dhe atyre të interesave të parashtruesit të ankesës.

Paneli konstatoi se parashtruesit të ankesës nuk iu janë dhënë arsyet me shkrim për arsyet e mosekzekutimit të vendimit të KPM. Më tej u konstatua se ShM nuk ka ofruar asnjë arsye, bazuar në faktet konkrete të rastit se për çfarë arsye rikthimi i

<sup>12</sup> *Ish mbreti i Greqisë dhe të Tjerët kundër Greqisë* [GC], nr. 25701/94, §§ 79 dhe 82, KEDNj 2000-XII);

<sup>13</sup> *Jahn dhe të Tjerët kundër Gjermanisë* [GC], nos. 46720/99, 72203/01 dhe 72552/01, §§ 81-94, KEDNj 2005;

<sup>14</sup> *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, 23 shtator 1982, §§ 69-74, Series A nr. 52;

<sup>15</sup> *Beyeler kundër Italisë*, cituar më lart, § 120;

<sup>16</sup> *Megadat.com S.r.l. kundër Moldavisë*, nr. 21151/04, § 72, 8 prill 2008.

parashtruesit të ankesës në pozitën e tij më mëhershme do t'i dëmtonte interesat e shërbimit.

Gjithashtu, nuk është treguar që parashtruesi i ankesës ishte i njoftuar për ndonjë bazë të tillë faktike, qoftë me shkrim apo me gojë. Më tej u konstatua nga Paneli se ShM nuk ka paraqitur ndonjë argument për të treguar se refuzimi i QIF kishte ndonjë bazë ligjore.

Vetëm arsyet me shkrim rreth atij vendimi, duke treguar qartë bazën e tyre ligjore lidhur me rrethanat faktike konkrete të rastit, do të mund ta bënin të mundur një vlerësim objektiv *post-hoc* (pas ngjarjes) nëse vendimi ishte në përputhje me kërkesat e ligjshmërisë.

Duke pasur parasysh mungesën e arsyeve për vendimin e kontestuar dhe mos paraqitja e ndonjë dispozite ligjore që mund të interpretohej si bazë e saj ligjore, Paneli konstatoi se shkelja e dyshuar e së drejtës së parashtruesit të ankesës në gëzimin paqësor të pronës së tij, në formë të një "pritshmërie legjitime", nuk mund të konsiderohej "e ligjshme" brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Ky konstatim i Panelit sa i përket ligjshmërisë së vendimit të QIF bëri të panevojshme shqyrtimin nëse ajo ndërhyrje ishte përputhur me kërkesat shtesë që duhej të plotësoheshin në rast të ndonjë ndërhyrjeje me të drejtën e gëzimit paqësor në pronën e tij.

#### ***Shqyrtimi i zbatimit të rekomandimeve***

Në vendimet e datës 23 nëntor 2011, Paneli rishikoi zbatimin e rekomandimeve të veta nga ana e ShM në lëndët *Kazagic* dhe *Rudi*. Paneli vuri në dukje se EULEX-i kishte ndërmarrë masa të caktuara për t'iu qasur gjendjes së parashtruesit të ankesës brenda kornizës së mandatit ekzekutiv në lëndën *Kazagic*.

Paneli gjithashtu vuri në dukje se në lëndën *Rudi*, EULEX-i kishte zbatuar thelbin e rekomandimeve të Panelit. Paneli është i bindur se zbatimi i rekomandimeve të tij nga EULEX-i në këtë rast do të shkoj drejt rregullimit të namit profesional të parashtruesit të ankesës, që i ishte dëmtuar nga ky largim i padrejtë nga puna. Në përfundim, Paneli deklaroi se EULEX-i kishte ushtruar funksionet e veta ashtu siç duhej në të dyja lëndët dhe vendosi që të mbyll shqyrtimin e këtyre dy lëndëve.

Këto vendime mund të shihen në faqen e internetit të Panelit: [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu) në gjuhën shqipe, serbe she angleze.

## **7. Çështjet operative/administrative**

### ***7.1 Fushata informuese***

Koncept Dokumenti mbi Llogaridhënie i datës 29 tetor 2009, ndër të tjera, deklaroi në Paragrafin E, se

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

“...EULEX-i në Kosovë do të ofrojë shpërndarjen e duhur të informatave publike rreth Panelit dhe punës së tij...”.

Komandanti i Operacioneve Civile deklaroi në Paragrafin 3 të Udhëzimit të tij të datës 13 nëntor 2009 në lidhje me Panelin se “Udhërrëfyesi” për Planifikimin Civil dhe Mundësi Operacionale duhet të përfshijë, ndër të tjerash, “Përgatitjen e një fushate gjithëpërfshirëse PR”.

Rrjedhimisht, Paneli siç përshkruhet në këtë raport më lart është angazhuar në kryerjen e një fushate të gjerë informuese që prej qershorit të vitit 2010 për të njoftuar publikun e gjerë rreth Panelit. Kjo fushatë ka qenë mjaft efikase në ngritjen e vetëdijes rreth Panelit, veçanërisht në zonat urbane, aty ku EULEX-i është i përqendruar më shumë.

Sidoqoftë, përkundër përpjekjeve më të mira nga Paneli, ende ekziston një mungesë njohurie rreth Panelit dhe mandatit dhe punës së tij tek popullata në përgjithësi në disa qytete dhe fshatra. Prandaj është menduar që një transmetim i një reklame në televizion dhe radio do ta ndihmonte Panelin që të arrij tek popullsia më e gjerë nëpër qytete dhe fshatra, në veçanti në pjesët më të thella të Kosovës.

### 7.2 *Papranueshmëria e ankesve*

Rishikimi i lëndëve të Panelit tregon se një përqindje e lartë e ankesave janë shpallur të papranueshme. Kjo mund që pjesërisht të shpjegohet për shkak të kompetencave të kufizuara të Panelit. Nëse lexohen kompetencat, mund që gjithashtu të zbulohet se parashtruesit e ankesave nuk i përmbahen procedurave apo nuk i përmbahen kufizimeve të Panelit.

Ankesat që janë shpallur të papranueshme, ndër të tjera, kanë pasur njërën prej këtyre mangësive: ankesat kanë qenë të pabazuara në kuptimin se ato nuk kanë paraqitur ndonjë provë *prima facie* të shkeljeve të të drejtave të njeriut; ankesat ishin parashtruar pas skadimit të afatit kohor të përcaktuar në RrP dhe gjithashtu ato nuk iu kanë përmbajtur *ratione temporis* me RrP, pasi ato kishin të bënin me ngjarje që kishin ndodhur para themelimit të Panelit apo para hyrjes në fuqi të datave përkatëse operacionale.

Gjatë fushatës informuese në vitin 2012, Paneli do të kërkoj t’iu qaset këtyre çështjeve dhe mangësive, por duke pasur një theks të veçantë në ofrimin e informatave lidhur me kriteret për pranueshmërinë e ankesave.

### 7.3 *Anëtarët e stafit*

Njëra prej zyrtareve ligjore të Panelit ka dhënë dorëheqje më 6 dhjetor 2011, kurse Sekretariati ka zhvilluar së fundi intervista për plotësimin e këtij vendi të punës. Në mesin e kandidatëve, ishte vetëm një kandidat i mundshëm i dërguar, kështu që Sekretariati ishte i detyruar që t’i intervistonte kandidatët e mundshëm të kontraktuar, duke shpresuar se pozita e kontraktuar mund të ofrohet nga EULEX-i.

Kështu mungesa e pozitave të kontraktuara për punësimin e stafit në Panel vazhdon të paraqes vështirësi për Panelin gjatë këtij procesi që është duke vazhduar tani për

punësimin e një zytari tjetër ligjor. Sekretariati gjithashtu ka kërkuar nga EULEX-i në Kosovë të nis procesin e përzgjedhjes së një gjykatësi të EULEX-it, për ta zëvendësuar znj. Bednarek.

#### **7.4 Buxheti**

Paneli nuk ka ndonjë buxhet të dedikuar dhe kështu sa i përket kësaj është plotësisht i varur prej sistemit buxhetor të EULEX-it. Sidoqoftë, kjo nuk ka penguar punën ditore të Panelit përgjatë periudhës raportuese gjatë së cilës, ndër të tjera, Paneli ka trajtuar tridhjetë (30) ankesa.

Edhe pse Paneli është plotësisht i kënaqur me mbështetjen buxhetore dhe mbështetjen e kategorive të tjera që aq bujarisht ofrohen nga EULEX-i, do të ishte mjaft e dobishme për punën e Panelit nëse Misioni do të na financonte një reklamë në TV/Radio, etj. Qasja në burimet e veta buxhetore do ta rriste edhe më tej pavarësinë e tanishme dhe të perceptuar të Panelit.

Paneli dëshiron të shfrytëzoj këtë mundësi që të falënderohet lidhur me bashkëpunimin e shkëlqyeshëm, mbështetjen dhe ndihmën administrative që ka pranuar nga EULEX-i në Kosovë dhe në veçanti nga Zyra për çështje Gjinore dhe të Drejta të Njeriut, përmes së cilës Paneli komunikon dhe bashkëvepron në mënyrë efektive me EULEX-in në Kosovë.

## **8. Përfundim**

Paneli tani ka përfunduar vitin e parë të punës. Ka qenë ky një vit i ngarkuar për Panelin, ku janë parashtruar njëzet e tetë (28) ankesa. Paneli ka trajtuar tridhjetë (30) lëndë, ka zhvilluar diku njëqind e tridhjetë (130) aktivitete që lidhen me fushatën informuese dhe ka ndryshuar RrR e vet.

Paneli tani është i vendosur mirë brenda strukturës organizative të Bashkimit Evropian si një mekanizëm efektiv llogaridhënës për mbrojtjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në ushtrimin e autoritetit të Bashkimit Evropian në Misionet e Përbashkëta për Siguri dhe Mbrojtje.

Kështu, ky shërben si mjet për të siguruar llogaridhënien e EULEX-it për shkeljet e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksionit ekzekutiv në Kosovë, si dhe duke shërbyer, ndër të tjera, si një shembull i shkëlqyer për llogaridhënie rreth të drejtave të njeriut për institucionet shtetërore të Kosovës.

Si përfundim, Paneli përfaqëson një model të mundshëm të një një mekanizmi llogaridhënës të zbatueshëm dhe kuptimplotë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut atëherë kur Bashkimi Evropian do të ushtron funksion ekzekutiv në Misionet e ardhshme të Sigurisë së Përbashkët dhe Politikës së Mbrojtjes.

Për informata të tjera rreth Panelit shih [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu).

**SHTOJCA 1 Tabela e stafit**

<b>Paneli</b>	
<b>Antonio Balsamo</b>	Kryesues i Panelit
<b>Anna Bednarek</b>	Anëtare zëvendësuese, gjykatëse e EULEX-it 27 maj deri më 28 qershor 2011  Anëtare e Panelit 28 qershor deri më 14 dhjetor 2011
<b>Esma Erterzi</b>	Anëtare zëvendësuese, gjykatëse e EULEX-it 10 janar deri më 27 maj 2011  Anëtare e Panelit 27 maj deri më 2 qershor 2011
<b>Francesco Florit</b>	Anëtar i Panelit, gjykatës i EULEX-it deri më 17 prill 2011
<b>Gabriele Gaube</b>	Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjykatëse e EULEX-it deri më 31 dhjetor 2010
<b>Verginia Micheva Ruseva</b>	Anëtare zëvendësuese e Panelit, gjykatëse e EULEX-it prej 28 qershor 2011
<b>Magda Mierzewska</b>	Anëtare e Panelit

<b>Sekretariati</b>	
<b>John J. Ryan</b>	Zyrtar i lartë ligjor
<b>Leena Leikas</b>	Zyrtare ligjore
<b>Stephanie Selg</b>	Zyrtare ligjore prej 6 qershor deri më 31 dhjetor 2011
<b>Shpresa Gosalci</b>	Asistente administrative/gjuhësore (Shqip-Anglisht)
<b>Katica Kovacevic</b>	Përkthyes (Serbisht-Anglisht)

<b>Kushtrim Xhaferi</b>	Përkthyes (Shqip-Englisht)
-------------------------	-------------------------------

## **SHTOJCA 2 Orari i takimeve lidhur me fushatën informuese**

### ***Janar 2011***

*13 janar – Kryetar, Oda e Avokatëve të Kosovës*

- Sekretariati ka takuar z. Musa Dragushën, Kryetar i Odës së Avokatëve të Kosovës.

*20 janar – Programi evropian për Magjistraturë për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizim*

- Paneli është takuar me studentët e Programit Evropian për Magjistraturë rreth të drejtave të njeriut dhe demokratizim, Qendra evropiane ndër-Universitare për të drejtat e njeriut dhe demokratizim, Venecie, Itali.

*24-25 janar – Nisja e fushatës informuese në Republikën e Serbisë*

- Paneli dhe Sekretariati kanë nisur një fushatë informuese në Serbi me takime në Beograd dhe Prokuplje.

Paneli është takuar me z. Vladimir Ristic, i cili është ndihmës ministër në Ministrinë për Kosovë dhe Metohi në qeverinë e Republikës së Serbisë dhe me z. Slobodan Boskovic, i cili është ndihmës ministër në ministrinë e drejtësisë në qeverinë Republikës së Serbisë, në ndërtesën e qeverisë në Beograd më 24 janar 2011.

Përveç kësaj, gjatë fushatës informuese është mbajtur një takim me zyrtarët e këshillit danez për refugjatë në Beograd, kurse të pranishëm kanë qenë përfaqësues të Komisionit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara, si dhe OJQ-të që janë aktive në fushën e të drejtave të njeriut, siç janë Qendra e Ballkanit për Migracion, OJQ “Sveti Spas” dhe Grupi 484.

Takimi që Paneli ka zhvilluar gjatë fushatës informuese në Prokuplje të Serbisë më 25 janar ishte organizuar nga znj. Snezhana Zdravkovic, e cila është kryetare e Asociacionit për personat e zhdukur dhe rrëmbyer, dhe gjithashtu në këtë takim kishin marrë pjesë anëtarët e familjeve të personave të zhdukur.

*27 janar – intervistë me Radio Kosovën dhe Le Courier.*

- Anëtari i Panelit z. Francesco Florit ka zhvilluar një intervistë me znj. Serbeze Haxhijaj nga Radio Kosova dhe me Le Courier.

### ***Shkurt 2011***

*23 shkurt – Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës.*



## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

- Paneli ka mbajtur një takim gjatë fushatës informuese me përafërsisht pesëdhjetë (50) studentë të fakultetit juridik në sallën e fakultetit juridik të Universitetit të Prishtinës.

### *Mars 2011*

#### *02 mars – Intervistë me RTK-në.*

- Z. Francesco Florit (anëtar i Panelit) ka zhvilluar një intervistë me z. Nenad Radomirovic nga RTK.

#### *03 mars – Intervistë me Gazetën Zëri*

- Z. Florit ka zhvilluar një intervistë me znj. Selvije Bajramin, gazeta Zëri.

Paneli dhe Sekretariati kanë nisur fushatën informuese në nivelin komunal në Gjilan dhe Viti më 10 mars, kurse takimet e ndara dhe ngjarjet e tjera të zhvilluara paraqiten në vijim:

#### *10 mars – Rajoni dhe Komuna e Gjilanit*

- Z. Zuhdri Haziri, kryetar, gjykata e qarkut;
- Z. Omer Duraku, zëvendës kryetar i komunës, ndërtesa e komunës;
- Znj. Dragana Maksimovic, OJQ, programi për të drejtat civile, Kosovë;
- Z. Shaban Azizi, zëvendës komandant i stacionit, stacioni policor dhe z. Ismet Hashani, zëdhënës i policisë.

#### *10 mars – Komuna e Vitisë*

- Znj. Ibadete Hyseni, zyrtare për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore.

#### *16 mars – Komuna e Ferizajt*

- Znj. Vjollca Krasniqi, zyrtare për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore, Ndërtesa e Komunës;
- Z. Fatmir Karaliti, Shef i Operimeve, Stacioni i Policisë;
- Z. Avni Bytyqi, Drejtor Ekzekutiv, “Iniciativa për Progres” (OJQ-INPO).

#### *16 mars – Komuna e Kaçanikut*

- Z. Mehmet Ali Hajdini, zëvendës komandant i stacionit dhe shef i operimeve, stacioni i policisë;
- Z. Jeton Topalli, drejtor i administratës, ndërtesa e komunës;
- Z. Ramadan Gudaci, kryetar, gjykata komunale dhe z. Kemal Runjeva, administrator, gjykata komunale.

#### *22 mars – Komuna e Ranillugut*

- Z. Bojana Jevtic, zyrtar për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Gjinore.

#### *22 mars – Komuna e Kamenicës*

- Znj. Nazmije Demolli, koordinatorë për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore, dhe Zejnie Lenjani, zyrtare për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore;
- Z. Agim Lipovica, zëvendës komandant i stacionit të policisë, stacioni i policisë;
- Znj. Valbone Dervodelli, administratore, gjykata komunale.

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

### *23 mars – Komuna e Artanës*

- Znj. Sadbere Vllasaliu, zyrtare për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore, ndërtesa e komunës;
- Z. Ivica Zivkovic dhe z. Zoran Sumakovic, zyrtarë ndërlidhës të gjykatës komunale;
- Z. Goran Filic, hetues, stacioni i policisë.

### *29 mars – Komuna e Graçanicës*

- Z. Bratislav Trajkovic, komandant i stacionit; stacioni i policisë;
- Z. Trifun Jovanovic, zyrtar ndërlidhës i gjykatës komunale;
- Z. Bojan Stojanovic, kryetar i komunës, ndërtesa e komunës;
- Z. Sava Smigic, sekretar i Eparkisë, manastiri i Graçanicës;
- Z. Nenad Lazic, gjykatës, gjykata komunale.

### *29 mars – Konferencë për shtyp me TV Festina, TV Tema dhe Radio Stacioni i Ferizajt*

- Anëtarë i Panelit z. Francesco Florit ka mbajtur një konferencë për shtyp në zyrat e INPO-së (Iniciativa për Progres) në komunën e Ferizajt. Kjo ngjarje ishte organizuar nga z. Avni Bytyqi, i cili është drejtor ekzekutiv i “Iniciativës për Progres” në rajonin e Ferizajt. Intervista ishte zhvilluar nga z. Besim Idrizi dhe z. Shkodran Berisha (TV Festina), z. Petrit Ilazi (TV Tema) dhe z. Driton Ramadani (Radio stacioni i Ferizajt), e cila mbulon komunat e Ferizajt, Kaçanikut dhe Shtimes.

## **Prill 2011**

### *04 prill – Rajoni dhe Komuna e Prishtinës*

- Z. Abdullah Abazi, zëvendës komandant i stacionit të policisë - stacioni Veri;
- Z. Isak Ejupi, komandant i stacionit të policisë - stacioni Jug;
- Znj. Makifete Saliuka, kryetare, gjykata komunale;
- Znj. Tonka Berisha, zëvendës kryetare, gjykata e qarkut;
- Znj. Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore;
- Z. Tapio Vanamo, kryetar i dhomës së veçantë të gjykatës supreme të Kosovës.

### *06 prill – Universiteti Amerikan i Kosovës*

- Paneli është takuar me studentët e fakultetit juridik të Universitetit Amerikan të Kosovës në sallën e Universitetit Amerikan të Kosovës në Prishtinë.

06 prill – Takim publik në fushatën informuese me OJQ me titull “Dhuna ndaj grave”.

### *08 prill – Departamentet Qeveritare dhe Komunitat*

- Paneli është takuar me koordinatore për çështje gjinore dhe me zyrtarë nga departamentet qeveritare dhe nga komunitat në ndërtesën e qeverisë në Prishtinë.

### *11 prill – Z. Alexia Pierre, Studente për Doktoraturë në Kriminalistikë*

- Paneli është takuar me znj. Alexia Pierre, studente për Doktoraturë në Kriminalistikë, Universiteti i Liege të Belgjikës.

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

*14 prill – Komuna e Prishtinës*

- Z. Sami Halimi, komandant i stacionit të policisë; stacioni i policisë Qendër;

*14 prill – Drejtor Ekzekutiv, Oda e Avokatëve të Kosovës*

- Z. Yll Zekaj, drejtor ekzekutiv, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë.

*18 prill – Komuna e Vushtrrisë*

- Z. Bajram Mulaku, kryetar i komunës;
- Z. Blerim Hasani, shef i operimeve, stacioni i policisë;
- Z. Fadil Beqiri, zyrtar për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore;
- Z. Xhevat Abazi, kryetar, gjykata e qarkut;
- Znj. Afërdita Tahiri, administratore, gjykata komunale.

*19 prill – Rajoni i Prishtinës*

- Z. Isa Mustafa, kryetar i komunës.

### **Maj 2011**

*04 maj – Drejtor ekzekutiv, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut*

- Z. Bexhet Shala – drejtor ekzekutiv i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Prishtinë;

*04 maj – Kryetar i gjykatës kushtetuese.*

- Profesor doktor Enver Hasani - kryetar i gjykatës kushtetuese.

*06 maj – Znj. Jana Bauerova – Studente e nivelit të Magjistraturës në çështjet ndërkombëtare*

- Sekretariati është takuar me znj. Jana Bauerova – studente e nivelit të Magjistraturës në çështjet ndërkombëtare, Instituti i Studimeve Ndërkombëtare dhe Zhvillim të Gjenevës, Zvicër.

*31 maj – Komuna e Zveçanit*

- Z. Misko Acic – zëvendës kryetar i komunës;
- Z. Vasovic Predag - zyra e shefit të operimeve, stacioni i policisë.

*31 maj – Mitrovica e veriut*

- Z. Darko Gusnic, zëvendës komandant i stacionit të policisë.

### **Qershor 2011**

*6 qershor 2011 – Takimi i PShDNj*

- Paneli është takuar me z. Jean Marc Lacourciere, praktikant në Qendrën Juridike të Kosovës dhe student i fakultetit juridik në Universitetin McGill në Montreal, i cili është duke zhvilluar një hulumtim rreth të drejtave të njeriut dhe praktikës gjyqësore rreth të drejtave të pakicave në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

*10 qershor – Oda e Avokatëve të Kosovës*

- Sekretariati iu ka drejtuar me një fjalim Odës së Avokatëve të Kosovës në “Ditët e Avokatisë” në hotelin Grand në Prishtinë, ku kanë marrë pjesë disa qindra avokatë.

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

### *13 qershor – Komuna e Shtërpcës*

- Z. Dragan Ivanovic, komandant i stacionit;
- Z. Musa Kandjeli, gjykatës, gjykata për kundërvajtje;
- Z. Dalibor Jevtic, këshilltar dhe shef i kabinetit, zyra e kryetarit të komunës.

### *16 qershor – Komuna e Lipjanit*

- Z. Gani Zhaveli, kryetar i gjykatës komunale;
- Z. Agim Gashi, ushtrues detyre i komandantit të stacionit të policisë;
- Z. Shukri Buja, kryetar i komunës.

### *22 qershor – Komuna e Fushë Kosovës*

- Z. Burim Berisha, kryetar i komunës;
- Z. Bekim Zogiani, zëvendës komandant i stacionit të policisë.

### *22 qershor – Komuna e Obiliqit*

- Z. Fadil Ferati, zëvendës komandant i stacionit të policisë.

### *29 qershor – Kryetar i gjykatës Supreme të Kosovës*

- Z. Fejzullah Hasani, kryetar i gjykatës supreme të Kosovës.

### *30 qershor – Komuna e Obiliqit*

- Z. Mehmet Krasniqi, kryetar i komunës së Obiliqit.

## **Korrik 2011**

### *06 korrik – Komuna e Podujevës*

- Z. Agim Veliu, kryetar i komunës;
- Znj. Arjeta Podvorica, zyrtare për të drejtat e njeriut dhe çështje gjinore;
- Z. Naim Latifi, komandant i stacionit të policisë;
- Z. Aziz Podvorica, kryetar i gjykatës komunale.

### *12 korrik – Komuna e Shtimes*

- Z. Naim Ismajli, kryetar i komunës;
- Z. Bekim Qeriqi, zëvendës komandant i stacionit policor.

### *18 korrik – Shef i Partisë, Grupi i së Drejtës Ndërkombëtare dhe Politikave*

- Z. Henry McGowen, Shef i partisë, Grupi i së Drejtës Ndërkombëtare dhe Politikave, projekti në Kosovë, Prishtinë.

### *19 korrik – Komuna e Skenderajt*

- Z. Fadil Nura, zëvendës kryetar i komunës;
- Z. Agim Idrizi, zëvendës komandant i stacionit të policisë;
- Z. Isa Shala, kryetar, gjykatëa komunale.

### *19 korrik – Komuna e Glllogocit*

- Z. Sherif Krasniqi, zëvendës kryetar i komunës;
- Z. Bajram Rama, administrator.

### *19 korrik – Drejtor i Qendrës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim*

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

- Z. Sadat Gashi, drejtor i Qendrës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (shkolla e policisë, Vushtrri).

### *26 korrik – Komuna e Klinës*

- Z. Jashar Gashi, kryetar i gjykatës komunale;
- Z. Zemun Zegaj, zëvendës kryetar i komunës;
- Z. Engjëll Prenaj, zëvendës komandant i stacionit të policisë.

### *26 korrik – Komuna e Malishevës*

- Z. Haki Krasniqi, drejtor i administratës;
- Z. Lulzim Paçarizi, kryetar i gjykatës komunale;
- Z. Bekim Begaj, ushtrues detyre i komandantit të stacionit të policisë.

## **Gusht 2011**

### *04 gusht – Komuna e Istogut*

- Z. Hazbi Bajra, Drejtor i Administratës,
- Z. Qazim Jahi, Zëvendës komandant i stacionit policor,
- Z. Bajram Bujupaj, kryetar, Gjykata për kundërvajtje.

### *09 gusht – Komuna e Suharekës*

- Z. Arsim Berisha, komandant i stacionit policor;
- Z. Nuredin Abazi, kryetar, Gjykata komunale;
- Z. Refki Bytyqi, zëvendës kryetar i komunës dhe znj. Habibe Bytyqi, zyrtare për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore.

### *15 gusht – Takim me z. Astrit Istrefi, Saferworld*

Qëllimi i këtij takimi ishte që të bisedohej rreth mbledhjes e cila ishte propozuar të mbahej nga z. Istrefi më 25 korrik 2011 midis PShDNj (Panelit) dhe organizatave të shoqërisë civile (OSHC) në Kosovë.

### *16 gusht – Komunale e Rahovecit*

- Z. Smajl Latifi, kryetar i komunës, komuna e Rahovecit;
- Z. Muharrem Perboqi, kryetar, Gjykata komunale;
- Z. Fazil Morina, shef i operimeve.

### *22 gusht – Komuna e Gjakovës*

- Z. Agim Koci, Zëvendës kryetar i komunës dhe znj. Lumnie Shllaku, zyrtare për të Drejta të njeriut dhe barazi gjinore, Komuna e Gjakovës;
- Z. Hilmi Hoxha, Zëvendës kryetar dhe z. Rudin Elezi, administrator, Gjykata komunale, Komuna e Gjakovës;
- Kapiten Bekim Avdiaj, Komandant i stacionit të policisë, Komuna e Gjakovës.

## **Shtator 2011**

### *01 shtator – Komuna e Dragashit*

- Z. Avni Nebiu, Drejtor i Administratës dhe znj. Lindita Kozmaci Piraz, zyrtare për të drejta të njeriut dhe barazi gjinore,
- Znj. Sabaheta Kurtezi, kryetare, Gjykata Komunale
- Znj. Fhri Myrtezani, shef i njësisë së hetimeve.

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

### *07 shtator – Komuna e Deçanit*

- Z. Rasim Selmanaj, Kryetar i komunës,
- Znj. Safete Tolaj, kryetare, Gjykata komunale,
- Toger Sejd Dobraj, Komandant i stacionit policor,
- At Sava, Manastiri i Deçanit.

### *16 shtator – Institucioni i Avokatit të Popullit*

- Z. Sami Kurteshi, Institucioni i Avokatit të Popullit, Prishtinë

### **Tetor 2011**

#### *11 tetor – Komuna e Pejës*

- Z. Salih Mekaj, Kryetar, Gjykata e Qarkut të Pejës;
- Z. Bajram Kolic, Zëvendës komandant i stacionit, Stacioni policor rajonal i Pejës;
- Peshkop Jovan Liplanski, zëvendës peshkop i patriarkanës serbe, Komuna e Pejës;

#### *18 tetor – Komuna e Pejës*

- Z. Shefqet Uka, zëvendës kryetar i komunës, Komuna e Pejës dhe znj. Sebahate Corkadiu, zyrtare për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore;
- Z. Fatmir Baloku, zëvendës kryetar, gjykata komunale, Pejë;
- Kapiten Enver Gashi, komandant i stacionit policor; kolonel Ahmet Hasi, drejtor regjional; toger kolonel Nexhat Gutic dhe kolonel Nue Nikolla, Komuna e Pejës;

### **Nëntor 2011**

#### *02 nëntor – Komuna e Prizrenit*

- Z. Ruzhdi Rexha, zëvendës kryetar, dhe znj. Myvexhele Zuri, zyrtare për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, Komuna e Prizrenit;
- Znj. Nexhibe Bala, administratore, Gjykata komunale e Prizrenit;
- Kapiten Haris Dila, komandant i stacionit policor; Komuna e Prizrenit;

#### *21 nëntor – takimi i PShDNj me KDR*

- Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut kanë mbajtur një takim me znj. Kristen Stec, Këshilli Danez për Refugjatë.

#### *22 nëntor – Takimi i PShDNj me shefin e misionit të EULEX-it dhe Ekspertë për ndihmë juridike*

- Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut është takuar me shefin e misionit në zyrën qendrore të EULEX-it në Prishtinë;
- Tryezë e rrumbullakët në mes të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe ekspertëve për ndihmë juridike.

#### *23 nëntor – takimi i PShDNj me OSBE, KE, ZDKE*

- Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e OSBE, KE dhe ZDKE në ndërtesën e PShDNj. Qëllimi i këtyre takimeve ishte që të krijohet dhe zgjerohet bashkëpunimi midis Panelit dhe organizatave të lartpërmendura në të ardhmen;

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

### ***Dhjetor 2011***

#### *08 dhjetor*

- Sekretariati ka ndjekur seminarin për Mbrojtësit e të drejtave të njeriut, organizuar nga UNOHCHR, Prishtinë.

#### *09 dhjetor*

- Sekretariati ka ndjekur konferencën e Republikës së Kosovës rreth Ditës Ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ekspozitën “Komuna ime dhe të drejtat e njeriut”, Prishtinë.

#### *15 dhjetor*

- Sekretariati ka ndjekur Ceremoninë promovionale të publikimeve juridike, Qendra Juridike e Kosovës, Prishtinë.

### SHTOJCA 3      Statistikat

Kohëzgjatja mesatare e procedurave në Panel është diku 180 ditë, d.m.th. gjashtë muaj.

	2010	2011	Gjithsej
<b>Gjithsej raste të regjistruara</b>	<b>16</b>	<b>28</b>	<b>44</b>
<b>Gjithsej raste të përfunduara</b>	<b>6</b>	<b>30</b>	<b>36</b>
Të papranueshme	6	22	28
Shkelje	0	2	2
Nuk ka shkelje	0	5	5
Të hequra nga lista	0	1	1

<b>Statistikat</b>	<b>Deri më 31 dhjetor 2011</b>
Të pazgjidhura	8
Të papranueshme	28
Shkelje	2
Nuk ka shkelje	5
Të hequra nga lista	1
<b>Gjithsej raste të regjistruara deri në qershor 2010</b>	<b>44</b>

<b>Palët tjera në ankesë</b>	
Drejtësia	29
Policia	4
Doganat	0
Administrata e EULEX-it	5
Individë/ndërmarrje private	6
<b>Gjithsej</b>	<b>44</b>



**SHTOJCA 4            Vendimet e PShDNj-së**

	<b>Lënda</b>	<b>Parashtruesi i ankesës</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Rezultati</b>
1.	2010-01	Djeljalj Kazagic	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, çështje pronësore	shkelje
2.	2010-02	Sadik Thaqi	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës 04/09/2003	nuk ka shkelje
3.	2010-03	Osman Mehmetaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës 04/09/2003	nuk ka shkelje
4.	2010-04	Feti Demolli	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës 04/09/2003	nuk ka shkelje
5.	2010-05	Mursel Hasani	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës 04/09/2003	nuk ka shkelje
6.	2010-06	Latif Fanaj	Dyshohet në mos veprim nga prokurori i EULEX-it, vdekje në burgun e Dubravës 04/09/2003	nuk ka shkelje
7.	2010-07	Blerim Rudi	Dyshohet se Njësia e Inteligjencës Financiare nuk ka zbatuar urdhërin e marrë nga Këshilli i Pavarur Mbikqyrës që parashtruesi i ankesës të rikthehej në pozitën e vet të mëhershme të punës.	shkelje
8.	2010-08	Velimir Krstic	Dyshohet në mos veprim nga ana e policisë dhe prokurorisë së EULEX-it, çështje pronësore	e papranuesh me
9.	2010-09	Burim Ramadani	Dyshohet në mos funksionimin e sistemit gjyqësor, rasti <i>Kiçina</i>	e papranuesh me
10.	2010-10	Horst Proetel	Kandidaturë e pasuksesshme për një vend pune në EULEX	e papranuesh me
11.	2010-11	Laura Rudi	Pretendim financiar privat kundër një punëtori të EULEX-it	e papranuesh me
12.	2010-12	Hunaida Pasuli	Kandidaturë e pasuksesshme për një vend pune në EULEX	e papranuesh me
13.	2010-13	Një punëtor i EULEX-it	Kontest i brendshëm në EULEX lidhur me vlerësimin në punë dhe marrëdhëniet personale me mbikëqyrësin	e papranuesh me
14.	2010-14	Lulzim Gashi	Kandidaturë e pasuksesshme për një vend pune në EULEX	e papranuesh me

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

	Lënda	Parashtruesi i ankesës	Subjekti	Rezultati
15.	2010-15	Faton Sefa	Mos rikthimi në vendin e mëparshëm të punës (sektori privat), dyshohet në mos zbatimin e vendimit gjyqësor	e papranueshme
16.	2010-16	Cyma Agovic	Tranferuar nga EULEX-i – Mos shqyrtimi i drejtë i rastit të parashtrueses së ankesës nga ana e gjykatësve të EULEX-it	e papranueshme
17.	2011-01	Family of Dedë Gecaj	Kërkesë për hetimin e vendimit të ekstradimit të Gjykatave të EULEX-it në Kosovë në rastin e të ndjerit Dedë Gecaj	e papranueshme
18.	2011-02	Chamalagai Krishna Bahadur	Dyshohet për mos veprim	e papranueshme
19.	2011-03	Afrim Mustafa	Kontest lidhur me mbylljen e një radio stacioni privat dhe konfiskimin e pajisjeve të radio stacionit	e papranueshme
20.	2011-04	Besim Berisha	Ankesë lidhur me kushtet e jetesës në burgun e Dubravës	hequr nga lista
21.	2011-05	SH.P.K "Syri"	Dyshohet mohimi i së drejtës për një dëgjim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhVGjS.	e papranueshme
22.	2011-06	Milazim Blakqori	Dyshohet në mos zbatimin e një vendimi, mos veprim nga EULEX-i	e papranueshme
23.	2011-08	Anton Rruka	Dyshohet në mohim të së drejtës për dëgjim të drejtë, liri të shprehjes dhe barazi para ligjit, DhVGjS.	e papranueshme
24.	2011-09	Mirkovic Bojan	Dyshohet në largim nga puna prej EULEX-it në mënyrë të paligjshme	e papranueshme
25.	2011-10	Dejan Jovanovic	Dyshohet në vonesë të panevojshme gjatë procedurave pranë DhVGjS.	e papranueshme
26.	2011-11	Srecko Martinovic	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, trajtim jonjerëzor dhe mohim i së drejtës për gjykim të drejtë	e papranueshme
27.	2011-12	Novica Trajkovic	Dyshohet në përdorim të tepruar i forcës	e papranueshme
28.	2011-13	S.M.	Dyshohet në përdorim të tepruar të forcës, mohim i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe mos përfillja e së drejtës për jetë private	e papranueshme
29.	2011-14	Lindita Shabani	Dyshohet në mohim të së drejtës për jetë private dhe familjare	e papranueshme
30.	2011-15	Samedin Smajli	Dyshohet në mohim të një gjykimi të drejtë dhe vonesë të	e papranueshme

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

	<b>Lënda</b>	<b>Parashtruesi i ankesës</b>	<b>Subjekti</b>	<b>Rezultati</b>
			panevojshme gjatë procedurave	me
<b>31.</b>	<b>2011-16</b>	Avdyl Smajli	Dyshohet në mohim të një gjykimi të drejtë dhe vonesë të panevojshme gjatë procedurave	e papranueshme
<b>32.</b>	<b>2011-17</b>	Faik Azemi	Dyshohet në mohim të së drejtës për një dëgjim të drejtë	e papranueshme
<b>33.</b>	<b>2011-18</b>	Mykereme Hoxha	Dyshohet në mos veprim nga ana e prokurorit të EULEX-it	e papranueshme
<b>34.</b>	<b>2011-22</b>	Hysni Gashi	Dyshohet në mohim të një dëgjimi të drejtë dhe dyshohet në paaftësinë e gjykatësve të EULEX-it.	e papranueshme
<b>35.</b>	<b>2011-24</b>	Predrag Lazic	Dyshohet në mos realizimin e një dëgjimi të drejtë brenda një afati të arsyeshëm.	e papranueshme
<b>36.</b>	<b>2011-26</b>	Njazi Asllani	Dyshohet në mos zbatim të një vendimi, mos veprim nga ana e EULEX-it	e papranueshme

## **SHTOJA 5 Rregullorja e punës<sup>17</sup>**

### **Kapitulli 1. Dispozitat e përgjithshme**

#### *Rregulla 1. Qëllimi i Rregullores së Punës*

Rregullorja e punës ka për qëllim vendosjen e rregullave të cilat do të zbatohen nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (PShDNj) dhe të rregullave të cilat paraqiten para tij në procedurat të cilat përfshihen me Koncept Dokumentin mbi Llogaridhënie, i datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit Shqyrtues për të Drejtat e Njeriut.

#### *Rregulla 2. Definicionet*

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, vetëm nëse konteksti kërkon ndryshe, kuptimi i termave të mëposhtëm është si vijon:

- a. "Veprim i Përbashkët" do të thotë Veprimi i Përbashkët i Këshillit të Bashkimit Evropian nr. 2008/124/PPJS, i datës 4 shkurt 2008 për Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX, Kosovë;
- b. "Panel" do të thotë Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut;
- c. "Parashtrues i ankesës" do të thotë çdo person, përveç personelit të EULEX-it, që ka parashtruar një ankesë dhe që pretendon të ketë qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë përmbushjes së mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë;
- d. "Përfaqësues" do të thotë person i cili përfaqëson një parashtrues të ankesës gjatë procedurave pranë Panelit;
- e. "ShM" do të thotë Shefi i Misionit të EULEX-it.

### **Kapitulli 2. Organizimi i Panelit**

#### *Rregulla 3. Anëtarët e Panelit*

Paneli do të përbëhet prej anëtarëve ndërkombëtarë. Ai do të jetë i pavarur gjatë ushtrimit të funksioneve të veta.

Paneli do të përbëhet prej tre anëtarëve, prej të cilëve njëri do të jetë gjykatës i EULEX-it. Gjykatësi i EULEX-it do të emërojë një zëvendës.

Anëtarët e Panelit do t'i shërbejnë Panelit në mënyrë që ai të kryej funksionet e veta në mënyrë të paanshme dhe me ndershmëri.

---

<sup>17</sup> Siç është ndryshuar më 21 nëntor 2011.

*Rregulla 4. Procedura e përzgjedhjes dhe emërimit*

Dy anëtarë të Panelit, përveç gjykatësit të EULEX-it, do të përzgjidhen përmes konkursit.

Anëtarët e Panelit do të emërohen nga ShM për një afat kohor jo më pak se një vit.

Për rastin e gjykatësit të EULEX-it dhe zëvendësuesin e tij/saj, ShM emëron anëtarin e Panelit pas konsultimeve të kryera me Shefin e Komponentit të Drejtësisë. Shefi i Komponentit të Drejtësisë jep mendimin e vet pas konsultimeve të kryera me Kryetarin e Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it.

*Rregulla 5. Dorëheqja*

Dorëheqja e një anëtari të Panelit, ose zëvendësimi i gjykatësit të EULEX-it njoftohet tek Kryetari i Panelit, i cili do ta përcjell atë tek ShM.

*Rregulla 6. Zgjedhja e Kryetarit*

Anëtarët e Panelit do të zgjedhin njërin prej anëtarëve për Kryetar të Panelit. Gjatë procedurës së zgjedhjes së kryetarit mund të merr pjesë edhe anëtari zëvendësues. Në rast të barazimit, votimi përsëritet, duke përjashtuar anëtarin zëvendësues. Për kryetar nuk mund të caktohet gjykatësi i EULEX-it, e as zëvendësuesi i tij/saj. Mandati i kryetarit është për një vit, me mundësi të rizgjedhjes.

*Rregulla 7. Funkcionet e Kryetarit*

Kryetari drejton punën e Panelit.

*Rregulla 8. Zëvendësimi i Kryetarit*

Nëse Kryetari nuk është në gjendje të kryej detyrat e tij/ saj, apo nëse posti i Kryetarit është i lirë, detyrën e Kryetarit e kryen një anëtar tjetër që nuk është gjykatës i EULEX-it.

*Rregulla 9. Mbështetja nga Sekretariati*

1. Mbështetja e Panelit nga Sekretariati sigurohet përmes Zyrtarit të Lartë Ligjor dhe stafit të Sekretariatit.

2. Zyrtari i Lartë Ligjor, nën udhëzimin e Panelit do të jetë përgjegjës posaçërisht për:

- a. Të asistojë Panelin dhe anëtarët e tij në përmbushjen e detyrave të tyre;
- b. Të jetë kanal për të gjitha komunikimet lidhur me Panelin;
- c. Të mbikëqyrë arkivat e Panelit;

### **Kapitulli 3. Funkzioni i Panelit**

#### *Rregulla 10 Selia e Panelit*

1. Selia e Panelit do të jetë në Prishtinë.
2. Paneli mund të vendosë të kryej funksionet e veta diku tjetër në Kosovë, nëse e konsideron të përshtatshme.

#### *Rregulla 11. Seancat e Panelit*

1. Paneli do të mbajë seancat e tij të rregullta në çdo dy muaj. Caktimi i seancave të jashtëzakonshme varet nga Paneli.
2. Anëtarët të cilët janë të penguar prej ndonjë sëmundje apo arsye tjetër serioze që të marrin pjesë në një seancë të plotë të Panelit ose në një pjesë të saj apo nga përmbushja e ndonjë detyre tjetër të Panelit, duhet sa më shpejt që është e mundur të informojnë për këtë Kryetarin.

#### *Rregulla 12. Tërheqja*

1. Një anëtar i Panelit mund të mos merr pjesë në punimet e Panelit për shqyrtimin e ndonjë lënde, në rast se:
  - a. Ai ose ajo është në pozitë të konfliktit të interesit;
  - b. Ai ose ajo ka shprehur publikisht mendimin e tij/saj, nëpërmes medieve, me shkrim, nëpërmes veprimeve të tij/saj publike, të cilat objektivisht mund të ndikojnë në mënyrë jo të favorshme në paanshmërinë e tij/saj;
  - c. Për ndonjë arsye tjetër, pavarësia dhe paanshmëria e tij/saj legjitimisht mund të vihet në dyshim për ndonjë arsye.

2. Në rast të ndonjë dyshimi lidhur me ekzistimin e njëres prej arsyeve të përmendura në paragrafin 1, ajo çështje do të vendoset nga Paneli pa pjesëmarrjen e anëtarit përkatës.

#### *Rregulla 13. Shqyrtimet*

1. Paneli do të kryej shqyrtimet me dyer të mbyllura dhe shqyrtimet e tij do të mbesin të fshehta. Vetëm Zyrtari i Lartë Ligjor dhe anëtarët e Sekretariatit, përkthyesit dhe personat të cilët ofrojnë ndihmë tjetër për Panelin mund të marrin pjesë në këto takime, përveç nëse Paneli vendos ndryshe.
2. Procesverbali i shqyrtimit mbahet, *mes tjerash*, duke regjistruar emrat dhe funksionet e personave të pranishëm gjatë shqyrtimit.
3. Aty ku është e nevojshme që Paneli të vendosë për një pikë të procedurës që është jashtë seancës së caktuar të Panelit, Kryetari mund të udhëzojë që shqyrtimi të mbahet me prani të mjeteve elektronike.

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

### *Rregulla 14. Kuorumi*

1. Paneli mund të vendos vetëm nëse janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij apo, në rast të Rregullës 13, paragrafi 3, nëse të gjithë anëtarët e tij marrin pjesë në shqyrtim përmes mjeteve elektronike, me përjashtim të dispozitës nga paragrafi 3.
2. Në rast të dorëheqjes apo tërheqjes së anëtarit, i cili/cila është gjykatës i EULEX-it, apo nëse mungesa e tij/saj sipas Rregullës 11, paragrafi 2, ai/ajo përkohësisht do të zëvendësohet nga personi zëvendësues.
3. Në rast të dorëheqjes apo tërheqjes së një anëtari, me përjashtim të gjykatësit të EULEX-it, apo mungesës së tij/saj sipas Rregullës 11, paragrafi 2, Paneli mund të vendos me dy anëtarë të cilët janë të pranishëm apo marrin pjesë në shqyrtim përmes mjeteve elektronike. Në rast të barazimit, anëtari i cili/cila nuk është gjykatës i EULEX-it do të jep votën përfundimtare.

### *Rregulla 15. Votimi*

Vendimet e Panelit merren nga shumica e anëtarëve të cilët marrin pjesë në votim. Abstenimet nuk lejohen.

## **Kapitulli 4. Procedura**

### **A. Rregullat e Përgjithshme**

#### *Rregulla 16. Gjuhët*

1. Gjuhët zyrtare të Panelit janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze.
2. Versioni autentik i vendimit do të jetë në gjuhën angleze. Versioni në gjuhën angleze do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.
3. Në rast të konfliktit apo të mospërputhjeve ndërmjet versionit të dokumentit në gjuhën angleze ose të vendimit dhe versioneve të tij në gjuhën shqipe dhe serbe, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

#### *Rregulla 17. Përfaqësimi i ankuesve*

Ankuesit dhe, siç mund të ndodhë, përfaqësuesit e tyre të ligjshëm, mund të përfaqësohen para Panelit nga avokatët e tyre apo nga përfaqësues të tjerë sipas zgjedhjes së tyre.

#### *Rregulla 18. Përfaqësimi i Shefit të Misionit*

ShM mund t'i paraqes Panelit parashtrësë me shkrim ose një paraqitje me gojë apo të autorizojë një anëtar të Misionit për këtë qëllim.

#### *Rregulla 19. Veprimi në raste të veçanta*

## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

1. Paneli mundet, me propozim të tij ose me kërkesë të parashtruesit të ankesës apo të Shefit të Misionit, të merr çdo veprim të cilin e konsideron të përshtatshëm apo të nevojshëm për kryerjen e drejtë të detyrave të veta.

2. Paneli mund të kërkojë nga një apo më shumë anëtarë të tij të ndërmerr një veprim të tillë në emërin e tij, dhe veçanërisht të dëgjojë ekspertë apo persona të tjerë, që të ekzaminojë dokumente apo të vizitojë ndonjë lokacion. Ky anëtar apo anëtarë duhet t'i raportojnë Panelit për rezultatet e veprimeve që janë ndërmarrë.

### *Rregulla 20. Bashkimi i ankesave*

Paneli mundet, nëse konsideron se është në interes të zhvillimit të duhur të procedimit, të urdhërojë bashkimin e një apo më shumë ankesave.

### *Rregulla 21. Urdhri i procedimit të ankesave*

1. Paneli do të merret me ankesa sipas rendit kur ato janë bërë të gatshme për ekzaminim.

2. Paneli mund të vendosë për t'i dhënë prioritet një ankese të veçantë.

### *Rregulla 22. Masat e përkohshme*

1. Paneli apo, ku është e përshtatshme kryetari, mundet, me kërkesë të parashtruesit të ankesës, apo me propozimin e vet t'i propozojë SHM ndonjë masë të përkohshme për të cilën konsideron se duhet miratuar në interes të zhvillimit të duhur të procedimeve para tyre. SHM duhet të merr një vendim.

2. Paneli mund të kërkojë informatë nga parashtruesit të ankesës apo nga personat e tjerë për çfarëdo çështje në lidhje me zbatimin e ndonjë mase të përkohshme të vendosur nga ShM.

### *Rregulla 23. Afati kohor*

Afati kohor për informacion, vështrime apo komente të kërkuara nga parashtruesit të ankesës dhe ShM caktohen nga Paneli.

### *Rregulla 24. Shpenzimet*

Nuk parashihet ndonjë pagesë për parashtrim ose procedim të një ankese.

## **B. Ankesat**

### *Rregulla 25. Parashtrimi i ankesës*

1. Çdo person mund të parashtrojë ankesë, përveç personelit të EULEX-it në Kosovë, i cili/cila deklaron se është viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë përmbushjes së mandatit ekzekutiv të tij. Paneli nuk do të merret me shqyrtimin e seancave gjyqësore të gjykatave të Kosovës.



## Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut

2. Paneli do të shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me shkeljet e dyshuara të të drejtave të njeriut të cilat kanë ndodhur pas datës 9 dhjetor 2008 në Kosovë.
3. Ankesa duhet t'i dorëzohet Panelit brenda tre muajve nga data kur Paneli mund të pranojë ankesat, apo brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së deklaruar, cilado që është e përshtatshme për ankuesin.
4. Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim dhe duhet të nënshkruhet nga parashtruesit të ankesës.
5. Aty ku parashtruesi i ankesës përfaqësohet në pajtim me dispozitat nga Rregulla 17, një autorizim me shkrim i cili vërteton përfaqësimin e ankuesit duhet t'i paraqitet Panelit nga përfaqësuesi i tij/saj.

### *Rregulla 26. Përmbajtja e ankesës*

1. Ankesa duhet të përmbajë:
  1. Identitetin e ankuesit, duke përfshirë siç duhet: emrin, datën e lindjes, profesionin dhe adresën e personit në fjalë;
  2. Emrin, profesionin dhe adresën e përfaqësuesit, nëse ka;
  3. Një deklaratë mbi të gjitha faktet përkatëse;
  4. Një deklaratë përmbledhëse e shkeljeve të dyshuara të instrumenteve përkatëse për të drejtat e njeriut.
2. Parashtruesi i ankesës duhet të bashkëngjis çdo dëshmi dokumentuese, nëse ka, për të mbështetur ankesën, në veçanti për të treguar se janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë së saj.
3. Parashtruesi i ankesës mund të përdor një format standard të ankesës e cila sigurohet nga Paneli.

### *Rregulla 27. Regjistrimi i ankesave dhe informacioni për Shefin e Misionit*

1. Zyrtari i lartë ligjor do të mbajë një regjistër të ankesave, në të cilin do të shënohet, *mes tjerash*, data e regjistrimit të ankesës dhe data e përfundimit të procedimeve.
2. Pas regjistrimit të ankesës informohet Shefi i misionit.

### *Rregulla 28. Emërimi i raportuesit*

1. Kryetari duhet të emërojë një anëtar të Panelit si raportues, i cili/cila do të ekzaminojë ankesën.
2. Gjatë ekzaminimit të ankesës raportuesi:
  - a. Mund të kërkojë nga parashtruesi i ankesës dhe Shefi i Misionit që të dorëzojnë, brenda një afati kohor të caktuar, informacion faktik, dokumente dhe materiale të tjera, të cilat mund të konsiderohen si të rëndësishme;

- b. Dorëzon raporte të tilla, drafte dhe dokumente tjera, të cilat mund t'i ndihmojnë Panelit në kryerjen e funksioneve të veta.

### C. Shqyrtimi i ankesës

*Rregulla 29. Vendimi mbi papranueshmërinë pa komunikimin e ankesës tek Shefi i Misionit*

1. Paneli mund ta shpall ankesën të papranueshme gjatë procedimit përmbledhës nëse:
  - a. Për nga përmbajtja është e njëjtë me një çështje e cila është shqyrtuar nga Paneli dhe e cila nuk përmban ndonjë informacion shtesë të rëndësishme;
  - b. Është anonime;
  - c. Është paraqitur pas afateve kohore të paraqitura në Rregullën 25, paragrafi 3;
  - d. Është e pabazuar;
  - e. Është shpërdorim i të drejtës së parashtruesit të ankesës.
2. Vendimi i Panelit për papranueshmërinë do të përmbajë një përshkrim të shkurtër të fakteve të lëndës sikurse edhe arsyet e vendimit të tij. Paneli po ashtu do të deklarohet nëse vendimi është marrë njëzëri apo me shumicë votash. Rregulla 35 do të zbatohet *mutatis mutandis*.

*Rregulla 29 shtesë. Heqja e ankesës nga lista*

1. Paneli mund që të heq nga lista e rasteve ankesën në cilëndo fazë të procedimit, atëherë kur rrethanat çojnë në përfundim se:
  - a. Ankuesi nuk ka qëllim që të vazhdoj me ankesën e tij/saj; apo
  - b. Për ndonjë arsye tjetër të ngritur nga Paneli, nuk është e arsyeshme që të vazhdohet shqyrtimi i ankesës.
2. Paneli do të vazhdoj ta shqyrtoj ankesën nëse lind nevoja për zbatimin e të drejtave të njeriut.

*Rregulla 30. Komunikimi i ankesës tek Shefi i Misionit. Procedimet me shkrim*

1. Nëse procedura sipas Rregullës 29 nuk është e zbatueshme, Paneli mund të vendos të shqyrtoj pranueshmërinë dhe meritën njëkohësisht, ose ndaras.
2. Sidoqoftë, Paneli do ta informojë ShM për ankesën, duke e ftuar EULEX-in në Kosovë që të paraqes një koment me shkrim për ankesën dhe, pas pranimit të saj, të kërkojë nga Ankuesi të paraqes komente të mëtejme.
3. Paneli mund t'i kërkoj Ankuesit të paraqes ndonjë informacion faktik, dokument apo material tjetër i cili konsiderohet të jetë i rëndësishëm.

*Rregulla 31. Vërejtjet mbi papranueshmërinë*

Çdo vërejtje e bërë nga EULEX-i në Kosovë mbi papranueshmërinë e ankesës duhet të jenë me shkrim dhe të paraqitet sipas Rregullës 30.

*Rregulla 32. Vendimi mbi pranueshmërinë*

Pas pranimit të vërejtjeve me shkrim nga ShM dhe përgjigjet e mundshme, Paneli mund të vendosë mbi çështjen e pranueshmërisë së ankesës. Rregulla 29, paragrafi 2 do të zbatohet *mutatis mutandis*.

*Rregulla 33. Procedura me shkrim dhe me gojë*

1. Shqyrtimet e Panelit kryesisht do të bazohen në procedurën me shkrim.
2. Paneli mund të kërkojë që parashtruesi i ankesës të parashtojë dëshmi të tjera dhe vërejtje me shkrim.
3. Nëse Paneli konstaton se ankesa nuk mund të shqyrtohet vetëm në bazë të parashtrimit me shkrim, por që ky shqyrtim kërkon edhe një paraqitje me gojë, Paneli mund të pranojë një paraqitje të tillë me gojë. Kryetari do të organizojë dhe drejtojë paraqitjet me gojë. Anëtarët e Panelit mund t'ju parashtrojnë pyetje personave gjatë paraqitjeve të tyre me gojë përpara Panelit.

*Rregulla 34. Paraqitja e gjetjeve*

Pas përfundimit të shqyrtimit të ankesës, Paneli ia paraqet gjetjet e veta ShM, duke përfshirë edhe vendimin e Panelit mbi pranueshmërinë. Aty ku është e nevojshme, Paneli do të jap rekomandimet jo detyruese për veprime korrigjuese.

*Rregulla 35. Forma e gjetjeve*

1. Gjetjet do të përmbajnë:
  - a. Emrat e anëtarëve pjesëmarrës në Panel;
  - b. Datën e vendimit;
  - c. Përshkrimin e parashtruesit të ankesës dhe përfaqësuesit të tij/saj;
  - d. Një përmbledhje e procedurës së ndjekur;
  - e. Një deklaratë për faktet e lëndës;
  - f. Një përmbledhje e parashtrësive të pranuar;
  - g. Arsyet në pikat e ligjit;
  - h. Mendimin e Panelit;
  - i. Aty ku është e nevojshme, rekomandimet për veprime korrigjuese.

**D. Dëshmia**

*Rregulla 36. Dëshmia mbi të cilën bazohen gjetjet dhe vendimet*

Paneli do t'i bazojë vendimet dhe gjetjet e veta vetëm mbi dëshmi të cilat konsiderohet që kanë të bëjnë me ankesën, duke përfshirë dëshminë e mbledhur me vetiniciativën e tij.

*Rregulla 37. Parashtrimi i dëshmisë shtesë nga parashtruesi i ankesës*

Parashtruesi i ankesës mund të parashtrojë dëshmi shtesë në çdo kohë gjatë procedimit. Mirëpo, Paneli mundet, kur kjo është e nevojshme për kryerjen e duhur të detyrave, të vendos një afat kohor për parashtrimin e dëshmive të tilla.

**E. Nënshkrimi, shpërndarja, njoftimi dhe publikimi i vendimeve dhe gjetjeve**

*Rregulla 38. Nënshkrimi*

Vendimet dhe gjetjet do të nënshkruhen nga Kryetari dhe Zyrtari i lartë ligjor.

*Rregulla 39. Shpërndarja*

Vendimet dhe gjetjet do të shpërndahen në formë të shkruar.

*Rregulla 40. Njoftimi*

Parashtruesi i ankesës dhe SHM do të njoftohen mbi vendimet dhe gjetjet.

*Rregulla 41. Publikimi*

Vendimet dhe gjetjet do të publikohen me kohë në [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe, përveç nëse publikimi i tyre mund të ndikojë në efikasitetin operacional të Misionit apo në sigurinë e personelit të Misionit. SHM do të vendos për rastet e tilla pas konsultimit me anëtarët e Panelit.

**F. Rishqyrtimi i pranueshmërisë së ankesës, korrigjimi dhe ndreqja e gabimeve të gjetjeve**

*Rregulla 42. Rishqyrtimi i pranueshmërisë së ankesës*

1. Parashtruesi i ankesës, në rast të zbulimit të ndonjë fakti, i cili për nga natyra e tij mund të ketë ndikim vendimtar në pranueshmërinë e ankesës dhe i cili, kur është shpërndarë vendimi mbi papranueshmërinë, ka qenë i panjohur për Panelin dhe me arsye nuk ka qenë i njohur për Parashtruesin e ankesës, ai/ajo mund të kërkojë nga Paneli, brenda afatit kohor prej një muaji, pasi Parashtruesi i ankesës ishte njoftuar me faktet, që të rishqyrtojë pranueshmërinë e ankesës.

2. Në kërkesë duhet të saktësohet vendimi përkatës mbi papranueshmërinë dhe duhet të përmbajë informacion të nevojshëm për të treguar se kushtet që përmban paragrafi 1 janë në përputhje me të. Kërkesës duhet t'i bashkangjiten kopjet e të gjitha dokumentacioneve mbështetëse.

3. Paneli mund të hedh poshtë kërkesën, nëse nuk ekziston ndonjë arsye për të arsyetuar marrjen e saj parasys.

*Rregulla 43. Kërkesa për korrigjimin e gjetjeve*

1. Parashtruesi i ankesës, në rast të zbulimit të ndonjë fakti, i cili për nga natyra e tij mund të ketë ndikim vendimtar në pranueshmërinë e ankesës dhe i cili, kur është shpërndarë vendimi mbi papranueshmërinë, ka qenë i panjohur për Panelin dhe me arsye nuk ka qenë i njohur për parashtruesin e ankesës, ai/ajo mund të kërkojë nga Paneli, brenda afatit kohor prej një muaji, pasi parashtruesi i ankesës ishte njoftuar me faktet, që të korrigjojë konkludimet.
2. Në këtë kërkesë duhet të saktësohen konkludimet për të cilat kërkohet korrigjimi dhe ajo duhet të përmbajë informacion të nevojshëm për të treguar se kushtet që përmban paragrafi 1 janë në përputhje me të. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet nga një kopje e të gjitha dokumenteve mbështetëse.
3. Paneli mund të hedh poshtë kërkesën, nëse nuk ekziston ndonjë arsye e cila arsyeton marrjen e saj parasysh.
4. Nëse Paneli vendos të pranojë kërkesën, ai do t'ia komunikojë vendimin rreth kësaj parashtruesit të ankesës dhe Shefit të Misionit dhe do t'i ftojë ata që të parashtrojnë komentet e tyre me shkrim brenda afatit kohor të caktuar nga Paneli.

*Rregulla 44. Përmirësimi i gabimeve dhe revidimi redaksional*

Pa paragjykime ndaj Rregullës 42 dhe 43, Paneli mund të përmirësojë gabimet që janë të natyrës administrative, gabimet në kalkulim apo gabimet tjera të dukshme, në bazë të propozimit të vet apo në bazë të kërkesës nga parashtruesi i ankesës apo SHM. Kërkesa duhet të dorëzohet brenda një muaji, pas shpërndarjes së gjetjeve.

## **G. Devijimi**

*Rregulla 45. Devijimi për rastet individuale*

Dispozitat e këtij kapitulli nuk e ndalojnë Panelin nga devijimi gjatë konsiderimit të një rasti të veçantë, aty ku është e nevojshme, dhe për shkak të kryerjes së duhur të detyrave të tij.

## **Kapitulli 4 shtesë. Përcjellja e rekomandimeve të Panelit**

*Rregulla 45 shtesë*

1. Paneli do të përcjell zbatimin e këtyre rekomandimeve nga ana e SHM, pasi t'i ketë paraqitur këto rekomandime për veprime korrigjuese.
2. Vendimi i Panelit për zbatimin e rekomandimeve nga ana e SHM do të publikohet menjëherë në [www.hrrp.eu](http://www.hrrp.eu) në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe.

## **Kapitulli 5. Dispozitat përfundimtare**

### *Rregulla 46. Çështjet jo të udhëhequra nga Rregullorja e punës*

Çështjet jo të udhëhequra nga kjo Rregullore e punës do të vendosen nga Paneli duke respektuar funksionin e vet si Panel për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, parimet për një dëgjim të drejtë në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Veprimet të Përbashkët.

### *Rregulla 47. Versionet e gjuhëve të Rregullores së punës*

Kjo Rregullore e punës është miratuar në gjuhën angleze, që paraqet versionin origjinal. Teksti do të përkthehet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

**Ndryshuar dhe miratuar nga Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në Prishtinë, Kosovë, më 21 nëntor 2011.**

### **Anëtarët e Panelit:**

**Z. Antonio Balsamo**  
(Kryesues)

**Znj. Magda Mierzewska**  
(Anëtare e Panelit)

**Znj. Anna Bednarek**  
(Anëtare e Panelit)

**Znj. Verginia Micheva-Ruseva**  
(Anëtare zëvendësuese e Paneli)

**Z. John J. Ryan**  
(Zyrtar i lartë ligjor)